



Rolf Gollob / Peter Krapf

Hulumtimi mbi të drejtat e fëmijëve (edukimi mbi të drejtat e fëmijëve)



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE



БИРО ЗА РАЗВОЈ
НА ОБРАЗОВАНИЕТО

Doracak për arsimtarë

Hulumtimi mbi të drejtat e fëmijëve

(edukimi mbi të drejtat e fëmijëve)

Përmbajtja:

Hyrje	3
Pjesa e parë- Projekte të shkurtëra mbi të drejtat e fëmijëve për kl. 1-9	7
Katër principet bazë të Konventës mbi Të Drejtat e Fëmijëve.....	7
Ora I :Unë kam emër- ne kemi shkollë.....	8
Ora II:Emrat nuk janë vetëm shkronja!.....	12
Ora III: Ne jemi magjistat!.....	16
Ora IV Të drejtat tona- pasuria jonë.....	21
Ora V: Vete formulojmë (bejme) rregullat në klasën tonë.....	24
Ora VI: Të Drejtat e Fëmijëve: vepër artistike!.....	28
Ora VII:Ajo që dua, a është ajo, që më duhet?.....	32
Ora VIII: Ne vetë bëjmë portfolio (poster)	36
Ora IX :Pse patjetër, të respektojmë rregullat.....	39
Pyetjet kryesore për refleksion në orët për të Drejtat e Fëmijëve	41
Mësimi –leksioni 1: Nxënësit në fatkeqësi	42
Mësimi –leksioni 2 : Pse shkolla patjetër të kete rregulla?	43
Mësimi –leksioni 3 Kush krijon rregullat në jetë?.....	46
Pjesa e dytë- Informatë plotësuese,dokumente dhe material plotësues për shpjegim.....	48
-“Por kjo do të thotë se kam të drejtë për pushim,apo jo?”	
-Të Drejtat e Fëmijëve në klasë.....	48
-Duke mësuar të Drejtat e Fëmijëve:	
-Pyetje kryesore për zgjedhje të drejtë (duhur) të metodave mësimore.....	50
-Disa pyetje, shpesh të parashtruara në lidhje me të drejtat e fëmijëve nga	51
Konventa e Kombeve të Bashkuara	56
Tregojë të drejten! Edicioni rinor kanadez, jo konvencional për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve.	72
I Kemi ndikim , pse kemi të drejtë në pjesëmarrje?	72
II Aritja e potencialit tonë: kemi të drejtë të zhvillohemi në atë që jemi.	73
III-Të jetojme mirë:E drejta jonë për mbijetesë	74
IV-Të jesh i padëmtuar:E drejta jonë në mbrojtje	75

Hyrje

-Ky libër është doracak për arsimtarë të cilët kanë nevojë për mjete-vegla pune arsimore me qëllim për të mësuar nxënësit në shkollat fillore-mbi të Drejtat e Fëmijëve. Doracaku në fjalë përbëhet nga disa pjesë si vijon:

-Nëntë (9) projekte të vogla që sejcili përmban nga 4 leksione- pjesë për nxënës të shkollimit fillor prej klasës së parë deri në klasë të nëntë të shkollave fillore.

-Instruksione të detajuara, të cilat mund të përdoren për arsimtarë fillestar si dhe të shfrytëzohen për trajnim të arsimtarëve.

-Planifikimi i sejcilës përmbajtje mësimore (projekti) me pyetjet dhe detyrat kryesore (në fillim të sejcilit përshkrim të projektit në fjalë) që duhet realizuar sipas projektit në fjalë.

-Qasja mbi problemin paraqet “mësim përmes shembujve”, ku nxënësi ngritet mbi mësimin konceptuale, përsosshmërinë e aftësive dhe ndërtimin e një sistemi të drejtë të vlerave.

-Duke ndjekur principet kryesore të Arsimit për Qytetërim Demokratik, metodat dhe mënyrat e mësimi të hapur dhe kooperativ e përmbajnë e përbëjnë parësinë që buron nga Përmbajtja dhe principet e mësimi të të drejtave të fëmijëve (duke mësuar: PËR; PËRMES Dhe PËR SHKAK të të drejtave të njeriut)

-Vegël-mjete për refleksione (refleksion) dhe diskutim në orë.

-Pjesë- kushtuar për materiale dhe informata plotësuese për mësim të mëtejshëm dhe më të thelluar mbi të drejtat e fëmijëve.

Korniza konceptuale

Fëmijet duhet të dinë se cilat janë të drejtat e tyre, por, gjithashtu duhet të dinë, si ti respektojnë dhe aplikojnë ata në mënyrë të drejtë. Që kjo të arihet, shkolla doemos duhet të sigurojë teknika-metoda të ndryshme për mësimin e të Drejtave të Fëmijëve (mirë të praktikuar) edhe atë sipas Arsimit për Qytetërim Demokratik (AQD), të njohura si:

-Mësimi **për** të Drejtat e Fëmijëve: nxënësit i dinë dhe i kuptojnë të drejtat e tyre (dituri dhe kuptueshmëri). Mësimi i të Drejtave të Fëmijëve, nuk përjashton por kyç-aktivizon ligjërimin e arsimtarit në orë të veçantë dhe shfaq qëllim konkret.

-Mësimi **përmes** të Drejtave të Fëmijëve: nxënësi i përjetojnë të drejtat e tij si pjesë e bashkësisë shkollare dhe shoqërore (vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë).

-Mësimi **për shkak** të Drejtave të Fëmijëve: nxënësit marrin guximin për të shfrytëzuar të drejtat që kanë në disponim - favor të vetvetes dhe shkollës. Në këtë mënyrë ata përgaditen për rolin e tyre në të ardhmen – si qytetarë, mirë të informuar dhe aktiv në një shoqëri demokratike (si nxënës në shkollë dhe si individ të moshuar në shoqëri). Të mësuarit në frymën e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave njerëzore (**përmes**), dhe të mësuarit si të merr pjesë në shoqërinë demokratike, është obligim i mbarë bashkësisë shkollare. Gjithë arsimtarët dhe drejtorët duhet patjetër në mënyrë të drejtë të luajnë rolin e tyre, ashtu siç kërkohet patjetër të bëhet nga nxënësit dhe prindërit e tyre.

-Këto **tri** principe -shtylla, të të mësuarit nga Arsimi për Qytetërim Demokratik janë të përmbajtura dhe plotësohen njëra me tjetrën. Ky doracak demonstroi se si kjo është e mundur të realizohet.

“**Mësimi përmes**” të drejtave të fëmijëve paraqet zgjidhje me kujdes të metodave të cilat ju mundsojnë nxënësve të përjetojnë shkollën, si një “mikroshoqëri” e udhëhequr nga parimet-principet e të drejtave të fëmijut dhe njeriut. p.sh. patjetër duhet të ndjenë se janë të respektuar si personalitete, dhe se mendimi i tyre të dëgjohet gjatë të diskutuarit apo sjelljes së vendimeve. Përvoja doemos duhet të vijë në shprehje e të ndërlihet me informacionet dhe mendimet nga të drejtat e fëmijëve dhe njeriut. Ky është mësim “**për shkak**” të të drejtave të fëmijëve.

Të mësuarit përmes shembullit (qasja induktive)

Në këtë doracak është përvetësuar qasja klasike induktive-qasje mësimi përmes shembullit. Përmes të mësuarit e një apo më shumë shembujve, nxënësit mund të përfitojnë gjërisht dhe në mënyrë adekuate - përkatëse mbi të drejtat e fëmijëve - njeriut.

-Në doracak janë të shkruara “tri hapat” të cilave doemos arsimtarët duhet t’u përmbahen gjatë realizimit të mësimit përmes shembullit.

1.Arsimtari me kujdes përzgjedh shembullin dhe vendos përmes cilave metoda dhe teknika do të bëjë prezentimin para nxënësve.

2.Gjatë fazës së diskutimit dhe refleksioneve nxënësit krijojnë një fotografi gjenerale-globale dhe kuptojnë koncepte themelore- esenciale nga shembulli i prezentuar.

3.Nxënësit aplikojnë - përdorin përsëri pikëpamjet e posaformuara dhe kategoritë.

Me qëllim që t’u ndihmohet mësimeve në përdorimin e “hapit të dytë”, për të gjitha projektet- njësitë mësimore, shfrytëzohet e njëjta masë , gjeçësisht tri shtyllat esenciale-dimensionet e AQD ,gjatë të mësuarit mbi të drejtat e fëmijëve.

“Pyetjet kryesore” (çelës), shërbejnë për të kahëzuar (udhëhequr) vëmendjen e nxënësit gjatë orës, ndërsa “informata kthyesë”-përgjigja e nxënësit poashtu është e rëndësishme së madhe , sikurse qëllimi i orës, të cilën në asnjë moment nuk duhet përjashtuar – (haruar) arsimtari dhe nxënësi. Ajo duhet shprehur nga vetë fjalët e nxënësit si diç e qartë, e kuptueshme e shijuar dhe dëshiruar për të bërë në të ardhmen e tij. Me këmbimin e perceptimeve-parashikimeve të nxënësit gjatë kohës që ligjerojmë, ata mes veti kontribuojnë drejtë njohjes së qëllimit të dëshiruar.

-Proceset e të mësuarit do të jenë shumë më efektive nëse nxënësit dinë pse dhe me çfarë qëllimi mësojnë informata konkrete, koncepte dhe kategori, aftësi dhe principe të sjelljes në një shoqëri demokratike. Fazat e diskutimeve dhe refleksionit jo vetëm që duhet të potencojnë “konkluzat “ gjenerale nga shembujt e treguar, por edhe të perkushtohen në procesin e gjithëmbarshtëm edukativ.

Në kuptim të mësimit konstruktiv, vetë nxënësit duhet të vetëdijesohen për qasje vetanake-individuale të të mësuarit si tërësi dhe do të kuptojnë se cila mënyrë e të mësuarit më së shumti do t’u përgjigjet dhe se me çfarë nevoja specifike disponojnë. Të mësuarit në frymë të të drejtave të njeriut u jep guxim mësimeve që të krijojnë hapsirë dhe kohë, që nxënësit të mësojnë në harmoni, paralel nevojave të tyre.

-Shikuar nga aspekti i “udhëheqjes demokratike”, arsimtari dhe nxënësit duhet të harmonizojnë qëndrimet e tyre dhe bashkërisht të kujdesen në arritjen e qëllimeve gjatë orës mësimore, me të cilën procesi i planifikuar i njësisë mësimore, shëndrohet në ushtrim “të sjelljes demokratike të vendimeve”. Përfundimisht kjo formë e të mësuarit e të drejtave të fëmijëve paraqet model se si nxënësi duhet vetë të organizojnë procesin e të mësuarit.

-Në shoqëritë moderne proceset e ndryshimeve: në teknologji, ekonomi, globalizim të rrethit hapsinor, gjithnjë e më shumë bëhen më komplekse dhe më dinamike. Kjo tërheq-ngërthen “shkakun”-(sprovën), që brezat e rinj - gjeneratat e reja të arrijnë qëllimet e jetës në një të ardhme të marin pjesë aktive në sjelljen e vendimeve, me të cilat do të bëhen pjesë e procesit të “të mësuarit” gjatë gjithë jetës, dhe do të arrijnë deri te prolemet që ne sot, as që mund ti mendojmë. Prandaj nxënësit tonë duhet të aftësohen për mësim kooperativ për zgjedhje të “detyrave projektuese” si dhe problemeve të ndryshme.

-Në këtë doracak janë propozuar disa hapa të vegjël, me rëndësi të veçantë për nxënësit si të mësojnë, sepse ata janë në fillim të shek. të jetës së tyre.

-Në mbështetje të arsimtarit, çdo përshkrim i njësisë mësimore të projektit, përmban “tabelë” me pyetje kryesore të propozuara, të cilat arsimtari mund ti shfrytëzojë gjatë procesit të ligjërimit-shpjegimit.

-Principi i kësaj vegle pune, për “dimensionet” e procesit të të mësuarit mbi të drejtat e fëmijëve, është si vijon:

-Arsimtarët si dhe nxënësit , duhet pasur kujdes në atë se, çka ata dinë?

-Grupi i parë i pyetjeve i dedikohet arsimtarit-mësimeve.

-Grupi i dytë i pyetjeve ju detikohet nxënësve.

-Që të dy grupet e pyetjeve, synojnë të njëjtat dimensione - shtylla të mësimit AQD. Preferohet që arsimtarët të mos u ndihmojnë nxënësve, gjatë përgjigjeve të tyre.

Pyetjet kryesore për refleksion gjatë orëve për të drejtat e fëmijëve.		
Për	Përmes	Për shkak
A r s i m t a r i		
Çfarë dinë, tani nxënësit për të drejtat e fëmijëve?	Në çfarë mënyre shiqohen të drejta e fëmijëve në klase dhe bashkësinë shkollore?	Mësimi-si të meret aksion jashta shkollës? ç'mësuan nxënësit për jeten e tyre në të ardhmen?
N x ë n ë s i		
Ç'kam mësuar për të drejtat e fëmijëve?	Si i përjetova të drejtat e fëmijëve, në orë?	Ç'farë lloj aksioni, jam i gatshëm të ndërmar tani?

Nga tabela lexuelti mund të vërejtë se “vegla e të përshkruarit” mundëson përgjigjet e mundshme të cilat pritet të parashtrihen nga arsimtari apo nxënësi. Kjo është bërë me qëllim që të tregohet qartë se si mund të shfrytëzohet kjo vegël dhe çfarë rezultate mund të priten. Kuptohet mësimdhënësi mund të përgjigjet edhe në tjetër mënyrë, ngase nxënësit –përsëri, nuk do të përgjigjen gabimisht (ska përgjigje të gabuar), nëse nisen nga pervoja e tyre (**përmes**) ose paramendojnë ku mund të përdorin njohuritë e mësuara (**për**).

Në çdo rast përgjigjet e tyre do të kontribuojnë për evaluim të orës mësimore dhe do të mbështesin mësimdhënësin në tendencën për përmirësimin e kualitetit të punës së tij.

Mësimi i bazuar në detyra dhe roli i ri i arsimtarit

Njësitë mësimore janë të paramenduara si projekte të vogla; nxënësit ballafaqohen me probleme tipike për punë projektuese - te ndërlydhura me ndonjë temë konkrete, si organizimi i punës, komunikimi, racionalizimi i kohës etj.

Përmes gjetjes, zbulimit të mënyrave për identifikim dhe zgjidhje të problemeve nxënësit zhvillojnë aftësi të shumta:

Në temën e parë -1; fëmijevë u është dhënë detyrë të dizajnojnë lule, që do të mbaje emrin dhe fotografinë e tyre gjithashtu nga vetë ata varet se si do dizajnojnë lulen, ku do të gjenë metarialin e duhur, fotografinë ,si do të planifikojnë kohën etj. Në këtë mënyrë fëmijët do të mësojnë shumë gjatë kohës dhe detyrës së dhënë, por mesimdhënësi duhet pasur parasysh dhe doemos duhet menduar si do të perceptojë drejtë, detyrën dhe parashtrimin e pyetjeve si vijnë:

-Sa kohë ju nevojitet fëmijevë?

-Cilat materiale duhet ti sigurojë gjatë orës mësimore?

A duhet të sigurojë”lule të prera”- të gatshme?!

-Ky shembull tregon se tek fëmijët, që nga mosha e hershme , nxësim guxim për të marë përgjegjësinë në punën e tyre gjatë orës, duke ndarë atë së bashku me arsimtarin.

Kjo mënyrë e të mësuarit është shumë e rëndësishme, nëse në - të ardhmen nxënësit më të pavarur realizojnë detyrat e planifikuara. Në arsimimin - edukimin e të drejtave të njeriut, si degë e AQD-së , mësimdhënësi duhet të ndërmer dhe luaj shumë aktivitete dhe role.

-Mësimi “**për**” të dejtat e fëmijëve koresponдон me “funksionin klasik” të instruksioneve dhe informatave gjatë përpunimit të një teme të caktuar si p.sh.: leximi i detyrave, demonstrimi i videoklipeve etj.

-Mësimi “përmes” dhe “përshkak” të të drejtave për fëmijë dallohet nga mësimi për –ku arsimtari me sjelljen dhe rolin e tij duhet në mënyrë adekuate të ndikojë mbi nxënësin, duke pasur parasysh “respektin e ndërsjellë “ –faktorë kryesor i procesit edukativo-arsimor.

- Që kjo të jetë e arritshme , pra nxënësi të respektojë arsimtarin, gjegjësisht porosinë e tij. Ai (arsimtari) me përpikshmëri duhet të koordinojë sjelljen dhe veprimet e tij si psh. intonacionin e zërit, lëvizjet e matura, tolerancën, qartësinë, guximin, inkurajimin etj.

Ashtu siç është paraqitur në të gjitha njësitë mësimore-projektet, metodat e të shpjeguarit dhe të mësuarit janë ngushtë të lidhura me temën përkatëse. Mësimi i bazuar në detyra nënkupton planifikim dhe përgatitje adekuate të arsimtarit edhe pse roli i tij gjatë orës mësimore mund të duket edhe jo aq aktiv. Sidoqoftë derisa disa nxënës. punojnë, arsimtari për së afërmi duhet ta vëzhgojë dhe përcjellë punën e tyre me qëllim që të vëzhgojë aftësitë dhe nevojat e nxënësit duke patur parasysh dituritë, të kuptuarit , trajnimin e shkathtësive dhe qëndrimet e tyre.

Mirënjohje për autorin

Botimi i parë i këtij doracak u zhvillua me inisiativen e Institutit Pedagogik të Banja Llukës- B dhe H , nga një ekip arsimtarësh, të cilët verzionin e kësaj të librit e testuan në orët e tyre mësimore, në R. Serbe –B dhe H.

-Ky version u diskutua dhe përmirësua në shumë seminare.

Arsimtarët të rradhitur në vijim janë pjesëmarrës të seminareve për arsimin qytetar:

Hari Stojanoski, Munevera Fetah, Biljana Lazarova, Biljana Smilevska, Bukurie Bajrami, Jovan Gjorgjioski, Slavica Serafimoviq, Jasmina Petreska, Fadil Sulejmani,

Sasho Koçankovski, Biljana Cvetkovska, Snezhana Brzovska, Dragica Jovanovska, Svetlana Aleksovaska, Irena Ramzoska, Krste Llatovski, Naser Miftari, Lubinka Stoevska, Lupço

Nikollovski, Dobri Jovevski, Stojanka Dimkovski, Ellena Neshovska, Lupka Pançevska, Lupka Savinova , Xhemal Mehmed , Natasha Stefanovska, Zhaklina Jaglikovska

Ky serial doracakësh nga AQD është prodhim- rezultat i trajnimeve 10- vjeçare në vendet e EU Juglindore dhe EU- lindore të projekteve të organizuara nga Këshilli i Europës.

Andaj u jemi faleminderues partnerëve të Këshilit evropian për përkrahje dhe nxitje te përpunimit të këtij doracak: zot. Olof Olafsdotir, zot. Kristofer Rejnolds, zot. Emir Axhoviq.

-Cyril dhe Vengarten, -shkurt, 2006

Rolf Golob dhe Piter Kraf.

Pjesa e 1-rë

Projekte të shkurtëra për të drejtat e fëmijëve - për orët nga kl. 1-9

Ora	projekt	nocionet dhe termet kryesore	dituri dhe aftësi -shkathhtësi
Ora 1	Unë kam emër Ne kemi shkollë.	“Individi dhe shoqëria E drejta për arsimim	
Ora 2	Emrat nuk janë vetëm shkronja.	Karakter-personaliteti	
Ora 3	Ne jemi magjistat!	Problem të drejtat e fëmijëve të riturit në mjedis të shëndoshë dinjiteti	aktrimi
Ora 4	Të drejtat tona. Pasuria jonë.	Të drejtat e femijeve	bashkpunimi
Ora 5	Ne bëjmë rregullat Në klasën tonë	Shoqëria të drejtat, obligimet dhe rregullat. Disciplina, liria dhe rendi.	sjellje e vendimeve Bisedimi-bashkepunimi Diskutimi i vlerave
Ora 6	Të drejtat e fëmijëve -Vepër artistike	Principet themelore të të drejtave të fëmijëve	planifikimi i projektit
Ora 7	“Ajo që dua, a është ajo që më duhet “	dëshira dhe nevoja materiale dhe jomateriale	arritja e marveshjes (pajtueshmeria)
Ora 8	“ Vet bej poster” (panflete) “ Portofolio”	Thyerja-shkelja dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve	Puna ekimore refleksioni dhe informata kthyes-përgjigjet Planifikimi projektit.
Ora 9	“Pse patjetër duhet të respektojmë rregulla ?	Qëllimet e rregullave dhe ligjet Shkolla-si një mikroshoqëri	Mendimi kritik

Katër principet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve

1.Luajtja e roleve-e drejta jonë për pjesëmarrje

Neni 3; Prioriteti i nevojave të fëmijëve në diskutime politike,drejtësi

Neni 12;Liria e të menduarit dhe e drejta e zgjidhjes - votës

Neni 13;Liria e të shprehurit

Neni 14;Liria e mendimit,vetëdijes dhe besimit-religjionit

Neni 15;E drejta për asocim dhe protestë publike

Neni 16;Mbrojtja e privatësisë

Neni 17;Qasje në mendime dhe burime të informacionit

2.Aritje të potencialit tonë-e drejtë e jona për të zhvilluar atë që jemi

Neni 5; Mbrojtja e të drejtës prindërore

Neni 7;Mbrojtja e emrit të fëmijës dhe nacionaliteti

Neni 8;Mbrojtja e identitetit të fëmijëve

Neni 10;Ndihmë për bashkim familjar të fëmijës

Neni 21; Vëzhgimi i të adaptuarit të fëmijëve

Neni 23; Perkuajdesje e veçantë e të rinjve të hendikepuar

Neni 28; E drejta për arsimim

3.Të jetuarit mirë-e drejta për egzistencë

Neni 6; Mbrojtja e ekzistencës dhe zhvillimit

Neni 9; Parimet-principet e mosndarjes nga prindërit

Neni 18;Përgjegjësitë e prindërve dhe tutorit

Neni 24;Mbrojtja shëndetësore dhe përkujdesi mjekësor

Neni 27;Sigurimi social
 Neni 31;Edrejta e pushimit dhe aktiviteteteve të lira

4.Sigurimi nga dëmtimet-e drejta për mbrojtje

Neni 2; Principet e mosdiskriminimit
 Neni 11; Mbrojtja nga të privuarit-kidnapimi
 Neni 19;Mbrojtja nga keqëpërdorimi dhe maltretimi
 Neni 20;Perkujdesi i të rinjëve pa familje-bonjakëve
 Neni 22;Mbrojtja e fëmijëve të shpërngulur
 Neni 32;Mbrojtja nga eksploatimi ekonomik
 Neni 33;Mbrojtja nga droga-lëndë narkotike
 Neni 34;Mbrojtja nga eksploatimi gjinor-seksual
 Neni 35;Mbrojtja nga trafikimi dhe tregëtia me njerës
 Neni 36;Mbrojtja nga çdo lloj eksploatimi
 Neni 37;Mbrojtja nga keqëtrajtimet dhe dhuna
 Neni 38;Luftimet dhe konfliktet e armatosura
 Neni 39;Riintegrimi social i fëmijëve-viktimë
 Neni 40;Qëndrimi ndaj fëmijëve.-sipas ligjit denoncues

ORA 1
“Unë kam emër-Ne kemi shkollë”

Plani operativ i njësisë mësimore-projektit

Mësimi-leksioni	Pyetjet kryesore -përmbajtjet	Detyra kryesore	Materiali i duhur
Mësimi 1	Fëmijet i mësojnë emrat mes veti	Fëmijët njoftohen mes veti me emrat e tyre	Fleta letre me ngjyrë
Mësimi 2dhe 3	Sa dallohen nx.-fem. mes veti,ne kl. Tone?	Fëm.krijojnë lule me fotografitë e tyre në mes	Fl. letre me ngjyre,portret fotgr.te çdo fem.dhe flet – hamer-(flipçart)
Mësimi 4	Ç'fare dimë për njeri tjetrin?	Refleksioni i diskutimit “hyrës”	Posteri - panfleti final(i përfunduar)

Qëllimi arsimor:

-Nxenësit vetëdijësohen për llojllojshmërinë e emrave në klasen e tyre. Ato e çmojnë atë, që sejcili ka emër që dallon nga tjetri, kuptojnë se emri i tyre është vetem i tyre dhe se nuk mund t’ua merr kush dhe se ju takon “si ngjyrë”.

Fëmijët kuptojnë se më shumë emra të ndryshëm paraqesin më shumë karaktere-personalitete, kurse të gjithë përbejnë një “buket“ të madh e të shumlllojshëm lulësh.

Po e njëjta mund të arrihet edhe përmes variantit tjetër, si p.sh.”sa pika shiu”,ose “vagona treni” apo diç të ngjajshme. Por ajo që ne çdo moment duhet të na jetë e qartë është se “së bashku nuk jemi- vetëm më shume se të njëjtë”. Bëhemi buket, mjegull, liqen, tren, melodi etj.(“pjesë të ndryshme, përbejnë një të njëjtë me të madhe, më të fortë më të sukseseshme”).

Nxenësit kuptojnë dhe çmojnë se shkolla, ato i përkrah-mbështet, tani dhe në të ardhmen ,si individ apo bashkësi - kah mësimi i informatave të reja dhe arritje të diturive dhe aftësive të ndryshme e të shumta.

Ata kuptojnë se shkolla nuk është vetëm obligim dhe detyrë por është diç e krijuar-vetëm se fëmijët kanë të drejtë shkollimi-arsimimi, ndërsa prindërit e tyre, arsimtarët dhe shteti ua sigurojnë atë.



Pyetjet kryesore për refleksion për të drejtat e fëmijeve		
“Për”	“Përmes”	“Përshkak-përse”
A r s i m t a r i		
Ç’farë din tani fem.-nx.per të drejtat e fëmijëve?	Në ç’mënyrë vëzhgohen të drejtat e fëmij. në klasë dhe bashkësinë shkollore?	Mësimi-si të ndërmeret aksion jashtë shkolles-Çka mësuan nxen. per të ardhmen e jetës së tyre?
Neni 7, 28	Shkolla është pjesë e jetës sonë. Klasa është “mikro-shoqeri”. Buketi i luleve është simbol i fuqishëm për këtë.	Fëm.-nxën.vendosin ku duhet vënë posteri-panfletet me lulet e tyre! <div style="border: 1px solid black; padding: 2px; display: inline-block;"> 😊 😊 😊 😊 😊 </div>
N x ë n ë s i t		
Ç’farë mësova për të drejtat e fëmijëve?	Si i perjetova të drejtat e fëmijëve në klasë?	Ç’farë lloj aksioni jam i gatshëm të ndërmar tani?!
Si fëmijë- kemi të drejta të veçanta: -T’gjithë kemi emer,që askush nuk mund të na e mer.(neni 7) -Kemi të drejtë të shkojmë në shkollë, të mësojmë dhe lexojmë. Pa shkolle askush prej nesh nuk do të mundej të gjej pune (si njeri i ritur)	Sejcili prej nesh është i veçantë. Sejcili fëmijë është i mirëseardhur në orë mësimore. Do të ishte e demshme nëse dikush do të mungonte nga ora (mesimi) Të gjithë kemi të drejta të njejta.	Tani di se ndihem më mirë si pjesë e klases dhe se ajo është nje grup i mire. Do të tentoj(mundohem) që ti përmbaj të tjeret,që edhe ata te ndihen mirë, ashtu si ndihem unë.

Materili i nevojshëm:

- letra të prera në formë “zemre”
- gërshërë
- ngjitëse,
- letër me ngjyrë - kolazh vizatimor,
- fotografi të çdo nxënësi,
- “sello tep-ngjitëse trake”
- letër hamer

Rrjedha e orës mësimore – procedura

Mësimi – leksioni 1

1.Nxënësit rrijnë ulur në rreth. Në mes të rrethit janë vendosur zemra letre me ngjyra. Çdo zemër ka të shkruar emrin e sejcilit nxënësi të klasës, e në mes tyre

edhe një zemër letre me emrin e shkruar të arsimitarit të klasës.

Të gjitha “zemrat” kanë ngjithëse apo diç tjetër, për ta varur - ngjitur në trup, derisa zgjat aktiviteti.

2. Arsimtari i nxit fëm.-nxën.të përfshihen në bisedë:

-A i dimë emrat e të gjithëve-Kush është –kush?

-Sejçili nxën. mban emër-zemër të nxën.-fëm.tjetër të klasës dhe sejçili duhet të përgjigjet pyetjes:Çka ju pëlqen tek Ai? (emrin e të cilit ke zgjedhur nga mesi ...)

-Çka kam bërë deri tani me këtë fëmijë - nxën.?Çfarë do të më mungonte, poqese nuk do të ishim këtu?

-Poashtu mund të hapen-parashtrohen pyetje tjera si : çka kishit mundur të rëfeni për shokun apo dikend tjetër jashtë këtij rrethi, p.sh. arsimtari për ndonjë person nga familja apo ne shkolle ose shoqëria e tij.(qëllimi:dallimet dhe ngjashmërite tek njerezit).

3. Çdë fëmijë flet për ndonje tjetër, sipas zemrës prej letre me emrin e shënuar.

4. Çdo fëmijë mban zemren prej letre,gjatë gjithë mesimit - leksionit. Kjo bëhet derisa gjithë emrat nuk mësohen.

5. Arsimtari pyet:Pse zgjedha më shumë ngjyra,në vend se te zgjidhja një?

6. Arsimtari lutë, fëmijët, për të sjellur fotografi, për mësimin - leksionin e ardhshëm.

(Alternative: Arsimtari mund që të bëj vetë, fotografimin e nxën.)

Mësimi – leksioni 2 – 3

-Arsimtari shpjegon - jep sqarime:

Çdo nxënës në klasë,është ndryshe nga tjetri.

Çdo nxënës është i veçantë për nga ngjyra, personaliteti - karakteri, shkathtësitë individuale-personale dhe emri.

Ekzistojnë të drejta të fëmijeve. Gjitha të drejtat e fëmijëve janë të njëjta.

Për shembull:

-E drejta për (ne) emër.Neni 7;

-E drejta për arsimim.Neni 27;

Vetëm ai që ka emër personal (vetanak), mund të thirret nga të tjerët. Andaj është shumë me rëndësi të njihen dhe dihen emrat e të tjerëve!

(Po s’pate emër – s’të thërret askush)

Gjithë ne, me kualitete të ndryshme dhe lloje të personalitetit - karaktere,e përbejnë (formojmë) këtë paralele - klasë.

-Bëjmë foto - pasqyrë të klasës; atë e bëjmë prej luleve,e jo nga zemrat prej letre.

-Vazoja (e vizatuar) paraqet klasën apo godinen tonë shkollore, kurse të gjithë ne jemi lulet. Pa neve nuk do të egzistonte shkolla, por ajo do t’ ishte vetem nje vazo e thate-zbrazur.



Arsimtari jep sqarime për çdo hap të aktivitetëve.

Nxënësit 5 bëjnë vetë lulet e tyre, dizajnonë sipas dëshirës.

-Bëjnë ngjyrosjen e luleve, ngjesin fotografitë e tyre në mes.

-Lulet vendosen me rradhë, në forme buketi, ne letren e madhe ose hamer.

Në këtë mënyrë kemi bërë fotografinë shumëngjyrëshe të klasës sonë.

Fëmijët - nxën. ende, edhe më tej, mendojnë dhe mundohen të interpretojnë –fotografinë.
Arsimtarë shqyrton mendimet dhe idetë e ndryshme të nxën. Ata shprehen lirshëm, si dhe parashetrojnë pyetje (lirshem), si p.sh.

-Ç’ domethënie kanë lulet?

-Çka paraqet vazoja?

-Pse është e rëndësishme të kemi emër? Ç’ rëndësi ka emri?

Mvarësisht nga koha dhe materialet që kanë nxën. në disponim, ky aktivitet mund të realizohet në disa mënyra, si p.sh.:

-Fëmijët mund vetë të presin lule, vizatojnë dhe dekorojnë atë orë klase ose më parë të përgaditura .

-Arsimtari ka të përgaditur - gatshme mesin e lules, ndërsa fëmijët i krijojnë petalet, gjethet.

-Fotografitë priten proporcionalisht që të përshtaten me mesin e lules.

-Fëmijët që kanë mbaruar më herët, vizatojnë më shumë lule të vogla pa foto (qëllimi dekorimi sa më i mire i buketit).

-Vazoja paraqet “verzionin” e shkurtë të të drejtave të fëmijëve. (neni 7 dhe 28)

-Arsimtari krijon “fotografi-vizatim” me të gjitha lulet-vizatimet e krijuara nga nxënësit.

Mësimi-lekcioni 4

Vendosja –publikimi:

-Panfleti-posteri vendose ne derrase te zeze apo mure.

-Nxënësit qëndrojnë në gjysëmreth të madh, nëse klasa është e madhe , atëhere nevojiten dy gjysëmradhe. Preferohet që të gjithë nxën. Të kenë vend pozitiv me shiqim të mira kah fotografia.

Nxënësit mendojnë në pyetjet e radhës (si vijon):

-Si u ndjeva gjatë kohës së këtij aktiviteti?

-Çka mësova?

-Çka mësova për të tjerët?

-Çka di për arsimtarin?

-Arsimtari udhëzon diskutimin- bisedat e nxën., në rëfimin, komitetet dhe replikat e ndërsjella të tyre.

-Së fundi, mësimdhënësi ju jep nxën. disa informata mbi të drejtat e fëmijëve. Konkretisht ai apo ajo janë të fokusuar në të drejtat e treguara në fotografi , gjeçjesisht në vazo.

I informon nxën. për ditën ndërkombëtare të fëmijëve (20 nëntor).

Ai apo ajo diskutojnë në klasë reth posterit, se ku ai duhet vendosur. Klasa jep argumente “pro dhe kundër” , se ku duhet varur (posteri) në mënyrë që çdo vizitor të mund të shoh atë.

Si duhet vepruar në rast se edhe fëmijë tjerë do të na ishin bashkangjitur?



Emrat nuk janë vetëm shkronja!

Plani operativ i njesisë mësimore

Etapa -faza	Pyetje kryesore/permbajtja	Detyra kryesore	Materiali
Mësim –leksioni 1	Gjithë emrat tonë	Gjithë nxën mësojnë diçka më tepër mes veti për emrat e tyre (qasje interaktive)	Letër Fletë A4
Mësimi-leksioni 2	Si e mora emrin tim (kush ma dha emrin mua)	Klasa mendon reth arsyeve të të emëruarit (dhënies se emrit) të fëmijëve	Fletëza letre për fjali kryesore
Mësimi–leksioni 3	Gjithë fëmijët kanë mundësi të rëfejnë diçka.	Fëmijët shkëmbejnë informata reth jetës së tyre. Bëjn “fotografinë” e përgjithshme të jetës së tyre.	Informatë për familjet e fëmijëve (detyrë shtëpie) Një hamer (flip-çart) follmaster dhe ngjyra për çdo fëmijë.

Qëllimet arsimore

Neni 7; nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve mbron të drejtën e femjës për të pasur emër. Emri familjar vë në shënjestër gjegjësisht lidh fëmijën me grupin reth tij.

Sido qoftë emri personal ë mundëson femjës që të ndihet si individ, dhe qenie e veçantë në botë.



Nxënësit duhet të mburen me emrat e tyre dhe të dinë domethenien e tyre, çfare shpresa shprehin ato dhe pse prinderit kane zgjedhur, për të, emër.

Arsimtari doemos-patjeter duhet pasur kujdes gjatë kësaj teme, sepse nga arsye të ndryshme në klasë mund të ketë nxën., pa prindër biologjik ose që i kanë humbur emrat e tyre në raste migracioni ose ngjajshëm.

Mësimdhënësi duhet të ketë “ngushëllim” dhe simpati në qasjen e kësaj teme, me femijë-nxënës të këtillë.

Në vazhdimin e leksionit, nxën. shiqojnë vehtëvehten, me bashkëmoshatarët e tyre. Prandaj, kjo njësi mësimore vazhdon me pjesë nga njësia e kaluar, mirëpo mund të jetë edhe si tëresi e pavarur.

Pyetjet kryesore për refleksion në orët për të drejtat e njeriut		
Për	Përmes	Për shkak - pse
A r s i m t a r i		
Çka për momentin nxën. dijnë për të drejtat e fëmijëve?	Në çfarë mënyre hulumtohen të drejtat e fëmijeve në klase dhe në shoqërinë e klasës së tyre ?	Mësim si të ndërmeret aksion jashtë shkollës: Çka mësuuan nxën: për jetën e tyre të ardhshme?
Nenet 7, 8,12, 13	Shkolla është pjesë e jetës sonë, klasa është mikroshoqëri. Nxën, bëhen të vetëdijshëm për identitetin e tyre përmes njohjes se emrave të nxën. të tjerë dhe me atë që të gjithë në klasë thiren me emrat e tyre personal. Të drejta e shenuara në anën e djathtë përjetohen në klasë përmes kësaj teme.	Femijet marin pjesë në sjelljen e perfundimeve ku do të vendoset posteri. Ndoshta duhet që të sigurohet hapsirë e mjaftueshme për atë. Kjo mund që të diskutohet me ndihmës mësimdhënës dhe drejtor
N x ë n ë s i t		
Çfarë mësova për të drejtat e fëmijëve?	Si ë përjetova të drejtat e fëmijëve në orë?	Çfarë aksioni mund të ndërmarë tash, në pajtim me aftësite e mia?

Kemi të drejta të posatshme si fëmijë: Kemi emër të cilin askush nuk mund te na e mohon (neni 7). Si fëmijë tash më kemi ngjarje jetësore të tonën të ndryshëm nga jeta e tjerëve Kjo gjithmonë do të mbetet pjesë e imja (neni 8). Kam mendimin tim personal dhe mund të them (shprehem) çka të dua, gjithashtu edhe fëmijët tjerë (Nenet 12, 13)	Mësova se të gjithë nxën. në klasë dhe mësuesi me vërejtën. Të gjithë më dëgjuan , dhe tash të gjithë e dinë emrin tim. Për shkak të emrit unë jam i veçantë, i ndryshëm nga të gjithë të tjerët I mësova emrat e të gjithë nxën. në klasë. Dijë diçka edhe për jetën e tyre.	Në rast se takoj dikend në lojtore , ose në ndonjë vend tjetër, do ta pyes per emrin dhe njekohsisht do tia tregoj timin.
--	---	---

Materiali i nevojshëm

- Trakee prej letre
- Letër të madhe- madhësi hameri
- Revista të vjetra të ilustruara
- Ngjyra të ndryshme
- Brushë për ngjyrosje
- Disa palë gërsherë
- Komplete doracakësh.

Rrjedhja e orës mësimore - procedura mësimore

Mësimi –leksioni 1 : Gjithë emrat tonë!

Arsimtari (ja0 ulet në rrethe me nxën. e tij-saj.

Fëmijet-nxën. ulen në karige,

Në dorë mbajnë copë letre të shkruara me shkronja “të trasha” emrat e tyre.

Të njëjtën bën edhe arsimtari.

Gjithë me radhë tregojne emrin. Kështu mësojnë emrat mes veti!

Kjo mund të bëhet në disa mënyra:

- Fëmijët tregojnë emrat e atyre që gjenden pranë, duke treguar së pari emrin e tij:emri im është....,kurse nga ana ime e djathtë është...., edhe nga ana e majte është...
- Identifiko disa detaje të ngjajshme që kanë nxën. Psh. Ngjyra e veshjes, flokevë, syve etj. Formula gjëgjëze!...dhe gjithë diçka të përbashkët. Kush mund të na tregojë ç’është kjo, ç’fare kuptojmë me këtë, këtë e përsërisim disa herë.
- Mblidh gjithë kartelat me emrat e fëmijëve, iu japim fëmijëve që të vizatojnë pa e i lexuar emrat. Gjithë i tregojnë kartelat. Kush mund të sjellë në rregull gjithë këtë huti—kaos, gjegjësisht kush mund të emërojë fëmijët sipas emrit të vërtetë.
- Hypja në autobus: rastësisht fëmija fillon me shtëpzen e radhës.
- Unë jam Ana, une hyp në autobus, femija pranë Anës vazhdon, unë jam Sandra, edhe une hypi në autobus me Anën, fëmija pranë Sandrës, vazhdon të njejtën, por duke i përsëritur gjithë emrat e mëparshëm (të përmendur).

Në këtë mënyrë fëmijët do ti mësojnë shume më lehtë emrat e tyre.

Duhet pasur kujdes, që mos të turpërohet ndonje fëmijë , i cili haron pa thënë ndonjë nga emrat, andaj preferohet që të ndihmohen mes veti.

Arsimtari përfundon leksionin e 1-rë duke kryer një dialog instrukcial

Fjalitë në vijim i stimulojnë nxënësit:

- A e dua emrin që mbaj dhe nëse PO , atëhere pse?

-Ndonjëherë emrat , emrat ndryshohen (në të thirur) apo kalojnë në “nofke”, A e dua emrin tim të ri dhe pse?

-Me rëndësi është të kihet emer. Si do të ishte po të kishim të gjithë emra të njejtë apo të ishim pa emra?

Mësimi-leksioni 2: Si e fitova emrin unë!?

Arsimtari përgadit letra të prera- traka ma fjali , si vijon ☺ kuptohet fjalitë mund të jenë edhe të ndyshuara- sipas situates së dhënë).

Më rëndësi është të kesh emër.

Emri – ai jam unë.

Sipas emrave tonë njohim vehten por edhe të tjerët.

Përmes emrit ndërtojmë autoritetin tonë.

Me emër, fëmija bëhet anëtarë i bashkësisë.

Me përzgjedhjen e emrit, prindërit shpreh herë shprehin ndonjë dëshirë, shpresë apo ndjenjë personale.

Arsimtari lexon fjalinë e përgatitura dhe pyet nxën. për të sqaruar me fjalët e tyre, domethënien e emrit të vet.

Më pas arsimtari iu jep nxën. si detyrë shtëpie të shënojnë në fletore përgjigjet e pyetjeve si vijojnë:

-Kur kam lindur?

-Në sa ora?

-Cilën ditë te javës?

-Si ishte koha?

-Ku kam lindur?

-A ka qenë dikush prezent - kush?

-Sa isha i madh dhe i rënde? (sa peshoja)

-Si më është dhënë emri personal?

Mësimi-leksioni 3 dh 4 : Të gjithë fëmijët kanë ndonjë përrallë për të refyer!

Fëmijët qëndrojnë ulur në reth dhe referojnë për bisedat e prindërve të tyre.

Arsimtari i inkurajon për hulumtim më thellë ndonjëherë nga pyetjet.

P.sh. ajo ose ai; përgaditin tabelë me të dhënat e të gjithë nxën.-kur ata kanë lindur. Ndoshta kjo do të del nje skemë interesante. Kuptohet do të ishte më interesant përderisa nxën. do të mund të jepnin përgjigjen e pyetjes- si prinderit ju kanë dhënë emrin?

-Gjithë nxën. marin detyrë- që të punojnë në mënyrë individuale në përgaditjen e nje panfleti (pance) , me të gjitha informatat për vehten.

Arsimtari ndihmon nxën. nëse është e nevojshme rreth të shkruarit.

-Gjithashtu nxën. mund të (vizatojnë) , “bëjnë vizatim për jetën e tyre”

Kjo mund të bëhet në këtë mënyrë: fëmija-nxën. qëndron shtrirë mbi letër të bardhë, duke marë formën e dëshiruar, si psh. duke ngare, qëndrim në gatishmëri apo ndryshe..... dhe me laps reth trupit vizatojmë, duke terhequr vijen.

Nxënësit e përfundojnë leksionin e katër pasi mbarojnë me vizatimet.(posteret).

Se fundi diskutojnë Si dhe Ku do të ekspozohen materialet.

Arsimtari i përmban idetë e tyre.

Materiali i nevojshëm:

-Fletëza pune për nxënës

Emri im ka histori të veten –që do të tentojnë të dijë?

Kur kam lindur?

....

Në sa ora kam lindur?

Cila ditë e javës ka qenë?
Si ishte koha?
Ku kam lindur?
Kush ishte prezent?
Sa isha i madh dhe i rëndë?
Pse më është dhënë emri konkret?
Ora 3

Ne jemi magjistar!

Plani operativ i njësisë mësimore


Etapa	Pyetjet kryesore (permbajtja)	Detyra kryesore	Materiale
Mësimi- leksioni 1	Çka mund të bëjë personi – individi para një problemi? Çfarë mund të bëjë një magjistar?	Fëmijët-nxën. mësojnë të dallojnë zgjedhjet reale dhe “arcale-magjike” të një problemi. (Vizatojnë) përshkruajnë njeriun e rëndomtë ose “njeriun magjik”	Tabelë të përgaditur më parë për të mbledhur-shënuar idetë e fëmijëve: Letër A4, Ngjyra .
Leksioni 2	A mund të gjejmë zgjedhje përmes diskutimit - për problemin para të cilit gjindemi?	Përmes diskutimit-bisedës normale fëmijët - nxën. mësojnë të bëjnë dallimin mes zgjedhjes së mundshme dhe të pamundur të problemeve në jetën e përditshme.	-Figura të prera -prej letre, -ngjyra.
Leksioni 3	Çfarë zgjidhje mund të sjell? Si mund të ndihmojë?	Fëmijët-nxën. tentojnë të gjejnë zgjidhje (per) në situata të ndryshme të përditshmërisë sonë, zgjidhjet i prezantojnë përmes lojës dhe roleve	
Leksioni 4	Si mundesh përmes luajtjes së roleve të gjejmë zgjidhje? Çka mësuam në këtë mënyrë?	Fëm. - nxën. provojnë: rolet në klasë dhe aktrojnë në orë.	Mjete ndihmëse për të skenuar – dramatizues

Qëllimet arsimore:

-Fëm.- nxën. së shpejti vetëdijesohen dhe kuptojnë se shumë punë janë jashtë, kontrollës së tyre.

-Ato janë lëndë bazë për diskutime të shumta që direkt ndikojnë mbi jetën-(ardhmerinë) e tyre, dhe përsëri nuk janë në gjendje të ndikojnë mbi to, (kuptojnë problemin –por njëherit edhe faktin (se) që nuk mund të ndryshojnë atë)

Gjithashtu fëm.-nxën. prapë se prapë janë të aftë të“udhëtojnë në botën e tyre të fantazisë”-botë në të cilën mund të përfitojnë forcë para se të kthehen në jetën e tyre reale..



Për këtë projekt-njësi mësimore “propozojmë” shfrytëzimin maksimal të “fuqisë” së fëm.-nxën. dhe kreativitetin e tyre për vizatim dhe gjetje zgjidhje të problemeve të përditshmërisë.

-Fëm-nxën paramendojnë se janë magjistarë - ditë perditshmerie.

-Fëm-nxën paramendojnë se janë magjistarë – diç që sejcili fëmi apo I rritur s’paku njëherë ka dashur të jetë në jetë person I tillë.

-Ky projekt kërkon nga fëmi-nxën. Të identifikojnë situata nga rethi I tyre, të cilat dhe meritojnë zgjidhje më të mirë.

Me rëndësi është që fëm-nxën. të mos e teprojnë në kohë me fantazinë e tyre.

Duhet të vijnë deri te një zgjedhje adekuate të një problemi konkret nga mjedisi- rrethi lokal i tyre dhe të vehet në funksion.

-Propozojmë që fëm-nxën. të fokusohen në tema për mjedise jetsore të pastra dhe të shëndoshë në klas dhe në oborin e shkollës.

-Ky projekt njësi mësimore është bazë për komunikim në klasë, andaj është me rëndësi që fëm-nxën. te ulen në mënyrë përkatëse (konformë klimës të krijuar)!

Kur janë ulur në grupe, atëherë shiqimi i tyre duhet të jetë “sy më sy” (përballë njëri tjetrit).E nevojshme është orar renditje klasike e të ulurit të fëm-nxën.!

Pyetje kryesore për refleksion në orët mësimore mbi të drejtat e fëmijëve		
Për	Përmes	Përshkak
A r s i m t a r i		
Çka fëmijët-nxën. dinë për të drejtat e tyre?	Në ç’mënyrë janë vëzhguar principet e të drejtave të fëm-nxën. në klasë apo bashkësinë e shkollës	Si të ndërmeret aksion jashtë shkollës, ç’farë mësuan fëm-nxë. për jetën e tyre të ardhmen.
Nenet:13, 14, 28, 31	Shkolla është një mikroshoqëri Fëm-Nxën. Diskutojnë bashkarisht dhe zbulojnë zgjedhje të problemeve nga jeta e tyre. Interaksioni duhet tërë kohën jetuar mes fëm-nxën.- e jo vetëm me arsimtarin	Fëm-nxën. mendojnë për situata reale dhe zbulojnë zgjedhje të problemit , që është realë për ta.
N x ë n ë s i t		
Çka unë; ne mësuan për të drejtat e fëmijëve?	Si unë/ne i përjetuam të drejtat në orën mësimore?	Ç’farë akcioni jamë i gatshëm të ndërmarë tani?
Dije se fëmijët kanë të drejta të veçanta , të drejta të fëmijëve.	U dëgjuam mes veti dhe kuptuam se disa nga dëshirat dhe problemet tona mundë të kenë	Dije se unë dhe të tjerët kemi të drejta, por patjetër duhet të ndermarë diç, që të

Dije se ka ditë ndërkombëtare të fëmijëve “20 nëntori” Mësoj të dallojë “çudira” dhe zgjedhje reale të problemeve të përditshme.	dallime të mëdha. Pamë, se si së bashku mund të: gjejmë , zbulojmë zgjidhje të problemeve.	sigurohem se ato janë të mbrojtura, si nga unë ashtu edhe nga të tjerët. Gjetja e zgjidhjeve të problemeve, nuk është e lehtë dhe të gjithë ato nuk mund të zgjidhen përnjëherë.ë Dhe se disa dëshira tona nuk do të plotësohen për kohë të gjatë.
--	--	--

Materialet e nevojshme

Letra të zbrasta –fleta letre të zbrasta

Lapsa apo stilolapsa me ngjyra

Skema figurash (forma) për të prerë një letër”djem dhe vajza” (M dhe F) ose të prera nga arsimtari.

gërshërë nëse është e nevojshme,

Kostume për luajtje të roleve

Rrjedhja e orës mësimore-procedura rrjedhëse- etapore

Mësimi –leksioni 1

Arsimtari vizaton në tabel dy persona:burë apo grua të zakonshëm-rëndomt dhe një magjistar.Gjithashtu-edhe fëm,nxën, me pare-tandem i vizatojnë dy figurat (mundohen)tentojnë të përgjigjen në pyetjet që vijojnë:

-Si sillet njeriu i rëndomtë në situata të dhëna?

-Si vepron “ magjistari”në situata të tilla,të njejta.

Pas disa minuta,arsimtari i rreshton nxënësit në gjysmëreth para tabelës,ashtu që secili të ketë pamje të plotë (në klasa më të mëdha mund të rreshtohen në dy gjysmërrethe).

Arsimtari i mbledhe përgjigjet e nxën .pa dhënë komente dhe pa gjykuar asgjë,në flete letre dhe ivendos në tabelë ose murr.Propozojmë që tabela të përmbajë idet e fëmijëve,si në vijim:

Personi i rëndomtë (vizatim)	Magjistari (vizatim)
Uria	
Varfëria	
Mërzia-monotonia	
Ditëlindja	

Shiqojmë përgjigjet dhe fëm. Ju lejojmë të komentojnë. Kuptohet, ka edhe pyetje tjera të reja!Arsimtari don të dijë:

-A shiqoni-vereni ndonjë zgjidhje apo ide të paramenduar nga një magjistar i mirë apo i keq?

-Kur për herë të fundit dëshiroje të jesh magjistar dhe çfarë doje të ndryshosh?

-Cila është dëshira yte më e madhe tani?

Arsimtari nxit dhe inkurajon nxën. në të shprehurit e lirë të ideve dhe ju jep përkrahje pozitive. Poashtu ai jep sqarime se në të ardhmen disa herë do te flasin për magjistarin, dhe ju jep detyrë shtëpie që të shiqojnë revistë dhe libra me magjistarë dhe të njejtat ti sjellin në orë mësimi. Fotografitë dhe librat do të vendosen si një ekspozitë e vogel.

Në pjesen tjetër të mësimi, nxën. duhet ti përfundojnë vizatimet e tyre me magjistarë dhe persona-njerez të rëndomtë dhe të bëjnë ngjyrosjen e tyre.

Mësimi-leksioni 2

Gjatë javës, arsimtari shpeshherë i nxit nxënësit për të sjellur revista e libra me magjistarë, si dhe të perfundojnë me vizatimet e tyre dhe ti sjellin në shkollë.

Në fillim të mësimit të dytë, arsimtari i përkujton përmbajtjet e mësimit-leksionit të ardhshëm dhe sqaron procedurën e së njëjtes: tani do të shiqojmë në vizatimet, librat dhe gjësendet që ju i keni bërë vetë dhe sjellur në shkollë.

A mund të vëreni diç që është e ndryshme ose e përbashkët për gjithë ne?

Fëmijët tani jenë ulur në rrethe. Arsimtari tregon-spjeron se para disa vitesh janë shkruar të drejta speciale për tu ballafaquar me situat dhe jetën e fëmijëve. Këtu preferohet leximi i Deklaratës për të drejtat e Fëmijëve (1959); të cilën arsimtari mund ta kyç si të obligueshme. Konkretisht, nxënësi duhet të koncentrohet në principin e dytë.

Fëmijëve duhet t'u ofrohet shansi për t'u rritur me shëndet të mirë dhe kushte normale për jetë. Kjo ngërthen zhvillim:

- fizik,
- moral,
- psikologjik,
- mental dhe
- social - te çdo fëmijë.

Fëmijet-nxën. duhet të jetojnë dhe shijojnë lirinë dhe respektin e dinjitetit të tyre.

Nxënësit duhet kuptuar këtë princip që në hapin e parë. Me ndihmën e ideve dhe asociacioneve të nxënësve, arsimtari sqaron konceptin dhe lidhshmërinë mes tyre.

Në vijim, arsimtari në dysheme rreth 40 figura (meshkuj dhe femra) dhe i ndan ato në 4 grupe:

- Grupi 1: Zhvillimi-rritja i shëndetit fizik
- Grupi 2: Zhvillimi-rritja e shëndetit moral
- Grupi 3: Zhvillimi-rritja e shëndetit mental
- Grupi 4: Zhvillimi-rritja në mjedis të shëndoshë shoqëror.

*Më pas pyeten nxënësit se çka mund ti mungojë një fëmijë. Arsimtari mund të jep disa shembuj nëse është e nevojshme:

- | | |
|--|-----------------------|
| -Rritje të shëndetit fizik | ska veshje të nxehtë. |
| -Rritje të shëndetit moral | shokë të këqinj, |
| -Rritje të shëndetit mental | nuk ka libër të mirë |
| -Rritja në mjedis të shëndoshë shoqërorë | ska shokë. |

Arsimtari shënon çdo element që mungon te fëmija në figurën prej letre të fëmijës dhe prap e kthen në vend - dysheme. Më pas, arsimtari i lut fëmijët të japin idete e tyre. Fëmijët ndoshta nuk do të kenë mundësi të ballafaqohen me të gjithë kategoritë; në raste të kështilla arsimtari duhet t'ju jep përkrahje atyre (jo përgjigjet).

Pasi që identifikohen nevojat e fëmijëve të shkruara në letër duhet punuar me "magjistarët". Në grupe nga tre, fëmijët fitojnë po aq figura letre- sa anetar ka grupi.

Detyra e tyre është të përgjigjen në pyetjet si vijojnë:

- Shiqo-vëzhgo situatën e çdo fëmijë dhe mëso - kupto çfarë i bënë ato me fat apo pa fat?
- Si mund magjistarit të ndihmojë?
- Si mund ai ti ndihmojë fëmijët që të ndjehen mirë tani, nesër dhe pasnesër.
- Si mund të ndihmojë fëmijën që të mund ai të bëjë diç për vehte?
- Si njerezit e rëndomtë i zëvendësojnë magjistarët?
- Fëmijët përsëri reshtohen në reth dhe ndajnë zgjidhjet e tyre magjike

Mësimi-Leksioni 3

Tani të shiqojmë në situata konkrete nga jeta reale. Edhe njëherë arsimtari i perserit 10 parimet e të drejtave të femijeve dhe i stimulon ata të mendojnë për situata nga përditshmëria e tyre , në të cilën bashkëpjesmarësit, shokët, nxënës më të vjetër ose më të ri apo vet ata të mos ndihen mire. Lista e vendeve dhe situatave mund të jetë kështu:

Vendi:

- Klasa
- Obori i shkollës
- Rruga për në shkollë

Situata:

- Fjalosje dhe mospajtime
- Nuk ka drekë
- Të haruarit e detyrave të shtëpisë
- Rahje-përleshje fizike
- Mospasja e shokut- mikut
- Mospasja e njeëpalltoje të trashë dimri
- Mospasja e përgaditjes përkatëse adekuate sportive

Tani do të shiqojmë rolet e magjistarëve të vegjël. Do të ushtrojmë si të sjellim zgjidhje për situatat e këtu.

Ne raundin e parë shiqojmë 2 apo 3 situata. Pastaj nxën. formojnë grupe të vogla dhe zgjedhin një situatë, me të cilën duan të meren (mund të ndodh situatë”si huliganët rrahin nxënës tjerë” –e cila shumë herë mund të zgjedhet)

Fëmijët duhet luajtur skenë e cila tregon situata ngjajshëm me pyetjen dhe të propozojnë zgjedhje të cilën do ta shprehin përmes të luajturit e roleve të tyre.

Arsimtari i përmban grupet, jep propozime nëse është e nevojshme dhe dëgjon.

Për mësimin-leksionin 4 nxënësit mund të përmiresojnë lojën e roleve edhe me kostume.

Mësimi-Leksioni 4

Nxënësit i luajnë rolet e tyre në orë mësimi.

Pastaj diskutojnë, rreth pyetjes si këto skena mund të implementohen në jetën e tyre të përditshme.Pyetjet si vijojnë:

- Cilat situata i zbuluam?
- Si reaguam në situatën, pasi folëm në orë?
- A mund t’ a përmbajmë njëri –tjetrin?
- A të formojmë klubin e “ magjistarëve të mirë”?
- A duhet që ti informoj nxënësit të klasës së parë, tretë dhe të katërt në ditën ndërkombtare të fëmijëve (20 nëntorin)?

Të drejtat tona- pasuria jonë!Plani operativ

Etapat-fazat	Pyetje kryesore/përmbajtjen	Detyra kryesore	Materijali
Mësimi 1	Pse nevojiten të drejtat e veçanta për fëmijet?	Fëmijëve ju prezentojmë” kutin e çmueshme” kurse ata diskutojnë si të planifikojnë më mirë	Gjësende që mund të shfrytëzohen për prezantimin e të drejtave të caktuara të fëmijëve (demonstrimi dhe inspirimi; kartolina me të drejta të fëmijëve)
Mësimi 2	“Kutia ime e çmueshme”- diç speciale	Nxënësit dekorojnë kutinë e tyre dhe përgaditen për “ të drejtat e çmueshme të fëmijëve”	Çdo fëmijë çdo nxënës në shkollë sjell kuti të metaltë, të drunjtë apo prej kartoni; pulla me ngjyra, veshje; ngjitëse dhe gërshtë.
Mësimi 3 (pas një periudhe disajvëshe)	Kutia ime e çmueshme- kutia yte e çmueshme!	Nxënësit i tregojnë kutitë e tyre të çmueshme duke përgaditur ekspozitë në bangat e tyre.	Kutitë e çmueshme të nxënësve-me përmbajtje.
Mësimi 4 (para 20 nëntorit)	Si mund të organizohet ekspozita!	Fëmijët I ekspozojnë “ kutitë e çmueshme të tyre” në mënyrë që çdo nxënës të shiqoj si duhet atë.	Nxënëit vet ë gjejnë hapsiren për të organizuar ekspozitën

Qëllimi arsimore

Nxënësit hulumtojnë më gjërësishtë dituritë për të drejtat e fëmijëve. Kohë më të gjatë ata mësojnë të drejtat e tyre duke u munduar të gjejnë “gjësend” i cili më së miri do ta ilustron ndonjë të drejtë. Çdo fëmijë vet do të gjej zgjidhjen.

Në kuptim të mësimi teorik ,kjo detyrë ju lejon atyre që të mësojnë aktivisht, që të organizojnë proceset mësimore, me të cilën dukshëm zmadhojnë mundësinë për të zgjeruar njohuritë e tyre.



Çdo nxënës ndërton kutinë e vet të çmueshme. Ashtu fëmijët më fuqishëm e identifikojn vetveten me të drejtat e tyre në mënyrë emocionale dhe intelektuale.

Ky është projekt i cili kërkon kohë më të gjatë dhe i cili mund ti stimulojë fëmijët që të diskutojnë dhe harmonizojnë idetë e tyre.

Me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve (20 nënetori), nxënësit organizojnë ekspozitën e tyre me “kuti të çmueshme “ që do ti vendosin në vendin e zgjedhur më pare (në shkollë) për të prezantuar dituritë e tyre mbi të drejtat e fëmijëve në mënyrë të ilustruar.

Kjo i nxit dhe stimulon në mënyrë plotësuese edhe nxënësit e klseve tjera që edhe ato të bëjnë diç të ngjajshme.

Detyra kryesore për refleksin në orët për të drejtat e fëmijëve

Për	Përmes	Përshkak-përse
<i>A r s i m t a r i</i>		
Çfarë dinë tani fëmijët për të drejtat e tyre?	Në ç'mënyrë vëzhgohen principet për të drejtat e fëmijëve në klasë dhe bashkësinë shkollore?	Si të ndërmeret aksion jashtë shkollës; Ç'kane mësuar fëmijët për të ardhmen e jetës së tyre?
Gjitha të drejtat e fëmijëve prezantohen dhe diskutohen.	Çdo nxënës përjeton të drejtën e tij për të krijuar shprehje artistike, në këtë mënyrë nxënësit risin vetëbesimin dhe më shumë mësojnë për veten dhe të tjerët.	Nxënësit mësohen të sjellin vendime dhe të argumentojnë të njëjtat.
<i>N x ë n ë s i t</i>		
Çka mësova për të drejtat e njeriut?	Si përjtova unë dhe të tjerët të drejtat e fëmijëve në klasë?	Çfarë aksioni jam i gatshëm të ndërmarë tani?
Kohë të gjatë mësoj për të drejtat e fëmijëve. Doemos duhej të sjell vendim për çdo nenë, e atë mund ta arrij vetëm nëse ato i kame kuptuar drejte. Mësove se jo gjithëhere është lehtë të kuptohet Konventa mbi të drejtat e fëmijëve.	Shkëlqyeshëm është , derisa shkolla bëhet mjedis në të cilin do të mund të shifen aq vepra të shkëlqyera. Tani përjetova si ashtë të jem në shkollë.	Tani për mua gjitha nenet nga konventa janë njësoj të vlefshme. Mendoj rreth asaj se mbi cilat nene mund të jap kontributin tim dhe për atë se cilat nene nga konventa janë konkretisht të vlefshem për familjet tjera, regjionet apo vendet dhe çfarë mund te bëjë për ëe ndihmuar ata.

Materiali i nevojshëm:

- Kartolina- me të drejtat e fëmijëve,
- Kutia e çmueshme.
- Koleksion i materialeve të mbetura nga aktivitetet e më parshme,
- Ngjitëse ,-(Kostume –nëse nevojitet luajtja e roleve)

Rrjedha e orës mësimore-procedura

Mësimi – Leksioni 1 (në shtator)

Arsimtari vendos kuti të zbrazët, kartoline me të drejtat e fëmijëve dhe dy gjësende në tabelë, si psh.

*Neni 24: E drejta për shërbime të kujdesit shëndetësor-stetoskopi(I sjellur apo i vizatuar) simbol I mjekut.

*Neni 28 : E drejta për arsimim-çantë e ndonjë nxënësi apo diç tjetër

Arsimtari tani sqaron planin:

-Dita ndërkombëtare e fëmijëve 20 nëntori

-Deri me këtë datë, secili nxënës duhet të përfundojë me rutinë, gjegjësisht ta mbushë me gjësende përkatëse që u dedikohen të drejtave të fëmijëve-për prezetim

-Çdo nxënës vetëvendos se çfarë gjësende do të shty në rutinë e tij.

-Çdo kutij e nxënësit që më parë duhet të jetë e ngjyrosur, dekoruar mirë dhe të ketë të shënuar emrin- pronarin e kutisë

-Gjithë nxënësit i presin kartolinat me të drejtat e fëmijëve, i vendosin në kuti,-tani fillon gjuetia për pasuri!

-Fëmijët i shprehin idete dhe propozimet lidhur me kutite e tyre

-Nëse është e nevojshme arsimtari duhet të sigurojë; ngjitëse, ngjyra dhe brushë.

Mësimi – Leksioni 2

Fëmijët tregojnë materialet dhe fillojnë me dekorimin e kutive. I ndajnë materialet dhe ndihmojnë njëri - tjetrin.

-Gjatë këtij mësimi fëmijët diskutojnë rreth asaj se si të gjejnë gjësende përkatëse.

-“Gjuetia për pasurinë” duhet tju ndihmojë fëmijëve që ti njohin dhe ti kuptojnë drejtë “ të drejtat e fëmijëve”. Ata mund të zgjedhin mjet-objekt vetëm nëse mirë dhe drejte ka kuptuar nenin konkret apo të drejtën përkatëse.

-Gjatë kohës së mbledhjes të gjësendeve fëmijet duhet të ndërojnë-këmbejn idete dhe tregojnë çfarë kanë gjetur-zbuluar: Kush çka- gjetur për cilën të drejte-nenë?

Duhet tju lejohet mundësia për të kopjuar ide. Do të krijohet një lloj garë mes veti se kush ka rutinë më të bukurë, me ide më origjinale dhe kreative.

Arsimtari nuk ka nevojë të jep stimulacion plotësues.

Mësimi - leksioni 3

Një javë para ditës ndërkombëtare të fëmijëve (20nëntori) ; gjithë fëmijet i tregojn mjetet që kanë gjetur.Nuk është patjetër të ilustrohet çdo e drejte me gjësend.

-Fëmijet sqrojnë pse kanë zgjedhur mu atë (gjë)sende për prezetim të ndonjë të drejte. Arsimtari nuk jep mendim apo gjykim të tij personal - (pasiv).

Nën udhëheqjen e arsimtarit diskutohet se si të paraqitet ekspozita e tyra para nxënësve tjerë të shkollës..

A ka kuti prej qelqi , të cilat mundë ti shfrytëzojmë?A të vendosim tabele të vogla në ndërtesën-godinën shkollëre?A do ta shëndrojm klasën tonë në muzej për të drejtat e fëmijëve (me 20 nëntor), ndoshta edhe klas tjetër ka të njejtin plane.Si të meremi vesh për idete? A të thërasim drejtorin, pedagogin , arsimtare tjerë të shkollës , prind apo personelin teknik? A duhet të ushtrojme apo shkruajme kënge –poezi me rastin e kësaj date.

Mësimi -leksioni 4

Dita ndërkombëtare e fëmijëve-20 nëntor (ose ndonjë ditë më herët).

Fëmijet vendosin ekspozitën dhe informojnë fëmijet tjerë.

Arsimtari vendos a duhet të mbajë fjalim të shkurtë, që njëkohsisht nënkuptohet si fjalim për hapjen e ekspozitës

Ne vetë formulojmë-bëjmë rregulla në klasën tonë!**Plani operativ**

Etapat-fazat	Pyetjet kryesore/përmbajtja	Detyra kryesore	Material
Mësimi 1	Cilat të drejta i gëzon çdo person në klasë?	Puna në grupe, fëmijet përgadisnin listë të rregullave në orën e tyre.	Fletë letre A4; për çdo grup nga 1 fl.
Mësimi 2	Çfarë e bën një rregull të mirë? Pse janë të vlefshme?	Fëmijët mendojnë për principin e rrendit dhe rregullave.	Informatë për principet themelore të rregullave në demokraci; fl. A4
Mësimi 3	Si mund të funksionojnë të drejtat e fëm. në klasë?	Duke punuar në grupe nxënësit gjejnë rregulla në pajtim me të drejtat e fëmijeve.	Doracak, të kopjuar apo përshkruar nga fëmijet.
Mësimi 4	Krijimi i rregullave në grupe dhe përshtatshmëria-adaptimi i tyre në orën mësimore.	Nxënësit i krahasojnë idetë dhe mundohen të përshtaten në pajtim me rregullat.	

Qëllimi arsimor:

Kur bëjmë lidhshmërinë e rregullave në klasë nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, këto rregulla prekin shumë më thellë, me siguri, duke siguruar paqë dhe qetësi në klasë.

Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, nuk paraqesin vetëm bazë të normave të drejtësisë. Nëse ato mirëkuptohen dhe përdoren drejtë, do të shërbejnë edhe si instrument dhe udhërefyes për punën për ndërtimin e ngjashmërisë dhe drejtësisë në jetën e përditshme. Për nxënësit shkolla është element shumë i rëndësishëm, për disa edhe qendër e jetës së përditshme. Por shkolla është shumë më tepër se aq; ajo është vendi i vetëm ku nxënësit mund të mësojnë si të sillen në shoqëri. Shkolla, me fjalë tjera klasa me të gjitha elementet e saja, struktura dhe udhëheqësia e shkollës paraqesin model të shoqërisë në miniaturë.

Atë që nxënësit mësojnë në klasë, në dobi apo jo, ka shansa të mëdha për tu bartur në botë jashta shkollës apo bashkësisë shkollë.

Të drejtat dhe obligimet janë pjesë e patjetërsueshme e koncepteve. Vijnë si dita dhe nata apo vera dhe dimri. Të drejtat dhe përgjegjësitë varen nga njëra-tjetra. Të drejtat njerëzore nuk mund të kuptohen po qe se nuk respektohet, ndërlidhja mes të drejtave dhe përgjegjësisë.

Ky projekt do të fokusohet në disa nene nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, si vijon:

Neni 12; E drejta e fëmijëve për të qenë i dëgjuar mendimi ynë;

Neni 13; Liria në të shprehur;

Neni 28; E drejta për shkollim;

Neni 31; E drejta për kohë të lirë dhe rekreacion.

Pyetje kryesore për refleksion në orët për të drejtat e fëmijeve		
<i>për</i>	<i>përmes</i>	<i>Përshkak</i>
A r s i m t a r i		
Ç'fare dinë tani nxën. për të drejtat e fëmijeve?	Në çfarë mënyre përjetohen të drejtat e fëmijeve në klasë dhe bashkësi shkollore?	Mësimi-si të ndërmeret aksion jashta shkollës:Ç'mësuan nxënësit për të ardhmen e jetës së tyre?
	Ne këtë temë,fëmijet në mënyrë direkte mësojnë se nevojiten –duhen rregulla per te jetuar se bashku dhe kuptojnë se të drejtat e femijeve e definojnë një sistem të tillë rregullash.	Nxënësit kuptojnë se si ndërtohen rregullat në shoqërinë Demokratike.Tani mund te marin pjesë në proceset demokratike për të sjellur vendime.
N x ë n ë s i t		
Çka mësova për të drejtat e fëmijeve?	Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në orë?	Ç'farë aksioni jam i aftë të ndërmarë tani?
Tani dije se kam te drejte te mare pjese ne pergaditjen –perpunimin e rregullave ne klasen time. Jam I vetedishem se zhvillimi I Konventes per te drejtat e femijeve ka qen proces I ngjashem.	Femijët kuptojnë se të drejtat dhe obligime-detyrat janë të pandara –të përbashkëta.Nënkuptojnë se rregullat dhe të drejtat janë të krijuara nga njerëzit dhe për njerëzit,dhe se mund të ndërrohen-ndryshojnë dhe se nuk është lehtë që sejcili të pajtohet me rregullat obligative në suaza të ndonje grupi.	Tani mund të gjej rregulla të ngjashme për bashkëjetesë me familjen time , shoket e mi apo në klubet sportive. Në përpunimin e rregullave të tilla, me rëndësi është që për ato të kyçen sa më shumë njerës dhe të jenë të aftëp për mirëkuptim dhe kompromis.

Materiali i nevojshëm:

- Fotografi-të prera nga revista dhe gazeta
- Gërshërë
- Ngjitëse
- Revista
- Fletë letre

Rrjedha e orës mësimore-procedura

Mësimi –leksioni 1

Arsimtari e paraqet projektin-njës.mes.

Ai apo Ajo,diskutojnë për”të drejtat dhe obligimet”me nxënësit.

Pastaj mësimi –leksioni vazhdon sipas hapave nga doracaku i Këshillit të UE-së.

1.Përmes lojës formojmë grupet e nx. në klasë.(nxënësit i grupojmë duke i emëruar ata si:violonisti,gitaristi etj. Duke iu ndarë kartolina adekuate.).Klasa ndahet ne 3,6 ose 9 grupe varësisht nga numri i nxënësve.

Më e preferueshme është qe grupi të mos ketë me shumë se 5 nxënës.

2. Çdo grup emëron një prezantues-spiker të gr.Nga ai kërkohmë përgjigje se si u zgjodh ai person?

3. Çdo grup ka fletë letre të ndara në 3 pjesë-fusha. Në pjesën e parë, ata shkruajnë atë që mendojnë se janë të drejtat e çdo personi-individi (duke e kyçur edhe arsimtarin), në klasën e tyre. Duhet propozime dhe të njëjtat numërohen (emërohen me numra).

4. Jep përgjigjen - Sa mire, mendon, se e ke kryer detyrën? Ç' bën të gjithë për të ndihmuar?

5. Përcille listën-fletën në grupin e rradhës (A kah B; B kah V; V kah A; -trekëndesh).

6. Mer parasysh të drejtat e shkruara nga grupi i mëparshëm.

Ç'farë përgjegjësie kemi që të respektojmë ato të të drejta?

Çka duhet bërë, si duhet të sillemi? P.sh. "Secili ka të drejtë të jet i dëgjuar - të përcillet dërisa flitet" poashtu "Kemi obligim të dëgjojmë".

Duke shfrytëzuar të njëjtat nene të të drejtave, në pjesën e dytë të letrës, shënoni përgjegjësitë, përkatëse-adekuate të po atyre neneve.

Në fund të mësimit, arsimtari i mbledh detyrat-fletëzat prej nxënësve, për të kontrolluar para mësimit-leksionit në vijim.

Mësimi-leksioni 2

Arsimtari i inkurajon nxënësit për të diskutuar për pyetjet themelore që kanë të bëjnë me rregullat:

- Çka me shqëteson lidhur me rregullat?

- Pse kenaqem kur ka rregulla?

- Kush i vendos rregullat?

- Kush i ve në praktikë ato, rregulla?

Teksti në vijim, mund ti ndihmojë nxënësit, të gjejnë përgjigjet e dy pyetjeve të para.

Materiali i nevojshëm:

Fletë punë për "disciplinën dhe rendin" nga perspektiva (këndvështrimi) demokratik

1. Rendi është i patjetersueshëm në çdo rrethanë. Grupi pa rend dhe rregulla nuk mund të jetë demokratik.
2. Kufinj të janë të patjetersueshëm. Rregullat mund të jenë të gabuara apo joadekuate, por derisa nuk zëvendësohen me të tjera, patjeter duhet të respektohen. Si do që të jetë, patjeter duhet mundësuar ndryshimin e tyre.
3. Prej fillimit nxënësit duhet të marrin pjesë në vënien - sjelljen dhe aplikimin e rregullave. Vetëm në këtë mënyrë, ata do të identifikohen me rregullat.
4. Bashkësia e shkollës nuk mund të funksionojë përderisa nuk ka rend dhe respekt të ndërsjellë. Në disa raste është vështirë të arihet atmosferë e tillë.
5. "Fryma e perbashkët", patjeter duhet të nderohet me "frymen garuese"
6. Atmosfera miqësore është me rëndësi vitale.
7. Shkathësitë socializuese të arsimtarit bartin rëndësinë bazike (për udhëheqje demokratike, zhvillimi i ndjenjës për përkatësi të një grupi, ndertimi i mardhënieve ndërnjerezore etj.)
8. Komunikimi grupor është i mundur në një orë të udhëhequr në mënyrë demokratike.
9. Nxënësit (meshkuj apo femra) duhet të inkurajohen pa ndërprerë në hulumtimin e diç të re-inovacion, dhe të mësojnë nga gabimet.
10. Në pajtim me kufijtë e caktuar, patjeter duhet të ketë edhe liri të caktuar. Vetëm në këtë mënyrë është e mundur të arihet "përgjegjësi individuale".
11. Disciplina dhe rendi do të praktikohen dhe respektohen më së shumti, nëse individëve ju mundësohet të shprehin lirshëm dhe nëse e permbajnë grupin, në zhvillimin e mardhënieve të kënaqshme dhe kushte-ambient pune.

"Grupi pa rend dhe rregulla nuk mund të jetë demokratik"

Nxënësit ju përkasin grupeve të njëjta nga mësimi i mëparshëm. Arsimtari shpërndan fletëzat dhe paraqet hyrjen, si vijon:

7. “Hyrja”-arsimtari.”Rregulla për rregulla”

-Zgjidh disa rregulla që në kontinuitet do të vihen re në klasë!

-Duhet të jenë pozitivisht të formuluar,si p. sh. “Bën diçka” është më mirë se “Mos bësh asgjë”

-Patjeter duhet të jenë konkret dhe të pershkruajnë “sjelljen e kërkuar”,p.sh. E drejta të jesh i dëgjuar; kemi përgjegjësi të ndëgjojmë; Rregulla-“Bëhu i qetë, derisa të tjerët flasin”

8. Lëviz - ndërroje ,përsëri pjesën e lëtrës. Meri parasysh të gjitha informatat nga grupi i mëparshëm. Zgjidh së paku 5 rregulla dhe shënoji ato me shkronja të mëdha në pjesëzën e tretë të letrës. Preje këtë pjesë dhe ngjite-vendose në murr. Sejcili folës-spiker i grupit i sqaron rregullat e mbarë klasës.

9. Votimi për rregulla.Çdo nxënës ka nga 4 “për”-propozime, të harxhojë për rregullat që mendon se duhet të jenë të kyçura në orë. Pastaj mund të përmbajnë-përkrahin 4 rregulla ose 1 rregull. Rregullat me më shumë vota, do të shfrytezohen në orë. Mund të shënohen si dokument i veçantë i nënshkruar nga sejcili nxënës.

10.Mësimi kooperativ. Ç’farë ndihmoj, e çfarë jo? Si kontribuove ti gjate aktivitetit? A vërejte dikë tjetër nga klasa, aktiviteti i të cilit ishte i dobishem? Ç’farë bën ata?

Kjo është mundësia e parë për nxënësit, të kenë përdorur rregullat e tyre. Arsimtari duhet ti patjetron nxënësit në respektimin e rregullave,por nuk duhet ti turpëroj, nëse nuk i respektojnë ato.

Mësimi-leksioni 3

Arsimtari –shkurtimisht i prezenton të drejtat e fëmijëve.

Për shumë nxënës kjo do të jetë një përsëritje:

-Si janë të krijuara?

-Si janë të lidhura me të drejtat e njeriut?

-Pse na nevoiten të drejtat e fëmijëve, pasi që kemi të drejtat e njeriut?

Tani arsimtari në vazhdim prezenton nene të selektuara nga të drejtat e fëmijëve.

Neni 12.-Të shprehurit e mendimit personal dhe interesi;

Neni 13.- Liria e të shprehurit personal;

Neni 28.- Edrejta për arsimim;

Neni 31.- E drejta për kohë të lirë dhe pushim.

Në hamer-letër të madhe, fëmijët,tërheqin dy vija jo te barabarta, të theksuara-vertikale (kolona).

Në kolonen e ngushtë, në të majtë, shënojnë 4 rregulla të radhitura, nga lartë-poshtë.

Në kolonën më të gjërë, nga e djathta, i mbledhin mendimet e tyre për të drejtat dhe obligimet që bartin rregullat në fjalë; për vetë dhe të tjerët: Nëse fqi im, shoku ose bashknxënësi im e vërteton këtë të drejtë, cilat obligime dhe angazhime –dalin nga të tjerët? Si e siguron shkolla arsimin? (neni 28).

Si anëtarë klase,si mund të kontribuojë unë, për sukses të kësaj rregulle?

Anëtarë të grupit (emerat e nx.)			
<i>Të drejtat</i>	<i>Rregullat</i>	<i>dhe</i>	<i>obligime</i>
Neni 12. Të shprehurit e pikëpamjeve tona dhe interesit. Për çka dedikohet?			
Neni 13. Liria e të shprehurit			

Për çka dedikohet?
Neni 28 E drejta për arsimim Për çka dedikohet?
Neni 31. E drejta për kohë të lirë dhe pushim. Për çka dedikohet

Mësimi – leksioni 4

Fëmijët i prezantojnë rregullat mes veti brenda orës. Sejcili grup ka folësin e vet.

Theksi i detyres mund të vëzhgohet nga aspekti që vijon:

- Si shtjelluam detyren? (proces i punës në grupe dhe sjellje vendimesh).
- Çka ishte e rëndësishme për ne? (kriteriumet dhe vlerat)
- Si sigurohemi se këto rregulla do të respektohen?

Nxënësit pajtohen me rregullat e tyre në orë. Njëri nga grupet mer detyrë të punojë dokumentin me të gjitha rregullat e shkruara në to. Të gjithë nxënësit dhe arsimtari e nënshkruajnë këtë dokument. Rregullat hyjnë në fuqi prej atij momenti, kur të vjetrat zëvendësohen me këtë dokument të ri. Dokumenti duhet të tregohet - prezantohet në "ditën ndërkombëtare të fëmijëve", si shembull i demokracisë në orë mësimore.

Ora 6

Të drejtat e fëmijëve – vepër artistike!

Plani operativ

Etapat-faza	Pyetjet kryesore-përmbajtja	Detyra kryesore	Materiali
Mësimi-leksioni 1	Ç'është projekti artistik? Si të prezantoj të drejtat e fëmijëve nga aspekti artistik?	Nxënësit vendosin cilin nen nga Konventa do të zgjedhin për të prezentuar si vepër artistike, dhe i zhvillojnë idetë e para.	Disa revista, Kartolina me të drejtat e fëmijëve, në copëza letre.
Mësimi 2 - 4	Si mund nxënësit dhe arsimtarët të përmbajnë njëri tjetrin? Si i shiqojmë se cilët janë punëtorë të shpejtë e cilët të ngadalshëm?	Nxënësit krijojnë një apo më shumë projekte. Mësojnë si duhet pranuar dhe dhënë ndihmë në orë mësimore.	Letër Ngjyra Ngjitëse Revista etj.

Qëllimi arsimor:

Të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut shpesh herë ndërliken me probleme të ndërlikuara politike, shoqërore apo personale.

Ky projekt i dedikohet traditës, që shumë herë përmendet në kontekst (suaza) të të drejtave të fëmijëve dhe njeriut.

Nxënësit (aktorë) marrin detyra konkrete të shprehin përmbajtjen e nenit të zgjedhur apo pjese neni, përmes fotografive. Në këtë mënyrë do krijohen më shumë kartolina të bukura, kalendar, libra po edhe filma.



Për ata nxënës të cilët veç kane punuar “kutin e çmueshme” gjatë projektit 3, ky projekt artistik do të ofrojë mundësi më të madhe për të mësuar të drejtat e fëmijëve.

Mendojmë se është e rëndësishme që nxënësit përsëri të mësojnë tema për të cilat tani diç kanë mësuar përmes burimeve të ndryshme, me fjalë tjera, përmes qasjes kreative dhe integruese.

Forma “folëse ose e shkruar”, mund të lejohet, vetëm nëse plotësisht është e qartë.

-Rekomandojmë që arsimtari në kohë të planifikojë aktivitetet për orët që të mund fotografitë të prezentohen në ekspozitën e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve - 20 nëntor; në shkollë, kuvend qyteti apo në ndonjë objekt me interes publik.

Qëllimi është që nxënësit të plotësojnë këtë detyrë me perkujdesje dhe kreativitet të përkushtuar e të patjetërsuar.

<i>Pyetjet kryesore për refleksion në orët për të drejtat e fëmijëve</i>		
për	përmes	Përshkak-përse
<i>A r s i m t a r i</i>		
Çka tani dijnë fëmijët për të drejtat e fëmijëve.?	Në ç'mënyrë vëzhgohen principet e të drejtave të fëmijëve në ore dhe bashkësinë shkollore?	Mësim - si të ndërmeret aksion jashtë shkollës: Ç'mësuan nxënësit për të ardhmen e jetës së tyre?
	Veçmas në orët e artit, nxënësit mund të kuptojnë se zhvillimi i mendimit individual dhe të shprehurit e tyre është i mundur dhe shumë i rëndësishëm. Zbulojnë men. individuale për të prezentuar të drejtat e fëmijëve në kuptimin artistik.	Nxën.janë emocionalisht të aftë për të kuptuar dhe gjykuar abuzimin-shkeljen e të drejtave të fëm. Këtë e kanë aritur përmes qasjes individuale të të mësuarit dhe t'kuptuarit e të drejtave të fëmijëve.
<i>N x ë n ë s i t</i>		
Çka mësova për të drejtat e fëmijëve?	Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në orë?	Ç'farë lloj aksioni jam i aftë të ndërmar tani.
Së bashku me shoket e mi-nxënës, i mësova të drejtat e fëmijëve. Parashtrova	Ky projekt kontribuon kah ajo që tërë shkolla të shëndrohet në godinë ku	U bëra më i vetëdijshëm për talentin tim artistik dhe tani jam me i guximshëm

shumë pyetje dhe di se nuk duhet të brengosem nëse ende nuk i kam kuptuar. Do të vazhdoj me të mësuar.	mora pjesë ne dekorimin e saj dhe ku ndihem si në shtëpi. Mund të shprehi individualitetin personal por edhe të tjerët me shiqojnë si një individ.	për trajnim dhe shfryëtzimin e talentit tim. Ajo është pjesë e karakterit tim dhe nga një herë më mundësojnë të shprehem shumë e më shumë nga ajo që mundem përmes fjalës apo tekstit të shkruar.
--	--	---

Materiali i nevojshëm:

Tekste për të drejtat e fëmijëve.

Rrjedha e orës mësimore – procedura

Mësimi – leksioni 1

Arsimtari në detale e prezenton projektin e ri.

Më rëndësi është që nxënësi të kuptoj principet bazë të këtij projekti; të përmbahen në orarin kohor dhe së paku të kenë parë shembuj nga shfaqjet artistike të të drejtave të fëmijëve.

Prandaj arsimtari jo vetëm që duhet të tregoj shembuj, por ai doemos duhet të demonstroj stile të ndryshme dhe qasje drejt zbulimit të talentit të fëmijëve që lirshëm të shprehen. Arsimtari mund të mendoj në bashkpunimin me kolegë, veçmas arsimtarin e artit, apo ndonjë artist nga mjedisi lokal. Kuptohet iniciativa dhe tërë aktiviteti, plotësisht mund t'ju lehet aftësive të nxënësve.

Pas hyrjes, nxënësit formojnë grupe të vogla për të planifikuar projektin.

Grupet do të ballafaqohen me pyetje, siç janë në vijim:

- materiali
- ngjyra
- vegla-mjete
- orari kohor;
- madhësia e fotografisë, koncepti artistik;
- planifikimi-organizimi i ekspozitës.

Grupet idetë e tyre i tregojn para të gjithëve në klasë.

Në fund të mëimit, nxënësit marrin një të drejtë me të cilën duhet të punojnë. Me që ka më shumë të drejta - nënë, se sa nxënës në klasë, arsimtari duhet të vendos cila është zgjidhja më e mirë:

- të ju mundësojë nxënësve vet të zgjedhin të drejtën që duhet punuar;
- nxënësve që punojnë më shpejt, të ju jep detyrë të ilustrojnë më shumë të drejta apo
- vetëm nxënësit e interesuar të ilustrojnë më shumë të drejta.

Klasa bashkëpunon me klasa tjera.

Sejcili nxënës mer kopje nga të gjitha të drejtat.

Fëmijëve ju jepet detyrë shtëpie, që duhet punuar javën e ardhshme; si vijon:

- lexo dhe analizo të drejtën që kë vizatuar, e cila do të ishte ndarë ty.
- provo të zhvillosh idenë se si atë të drejtë mund ta paraqesish si vepër artistike.
- mblidh shembuj nga revistat, gazetatat ose librat të cilat tregojnë-rrëfejnë shembuj të ndryshëm ilustrues.
- siguro materiale që do të nevoiten, dhe sjelli në shkollë.

Mësimi-leksioni 2

Nxënësit tregojnë dhe komentojnë idetë e tyre. Me rëndësi që nxënësit të kuptojnë të drejtat e tyre dhe të japin shembull se si ato të drejta realizohen.

Arsimtari duhet të insistojë që nxënësit vetë të sqarojnë të drejtat dhe mënyrat për ilustrimin e tyre.

Arsimtari duhet të jep vetëm disa komente rreth ideve të nxënësve.

Nxënësit duhet ti prezantojnë idetë e tyre, jo vetëm me fjalë.

Për nxënësit është mjaft motivuese p. sh. nëse ata bëjnë postera-panoa dhe ato të viren në mure të klasës. Këto prezantime nuk guxon të jenë të bezdisshme.

Mësimi – leksioni 2 – 4

Nxënësit mund të shfrytëzojnë gjysmën nga koha për mesimin e dytë dhe dy mësimet tjera në vijim për përfundimin e këtij projekti. Përvoja ka dëshmuar se nxënësit më të motivuar janë nëse ato nuk punojnë të izoluar mes veti. Arsimtari duhet të inkurajojë nxënësit të mos “kënaqen”vetëm me idenë e parë.

Arsimtari mund ta përmbajë klasen në krijimin e koleksionit të posterëve artistik , reklame ilustruese, diagrame etj. ,të prera nga gazetatat dhe revistat. Fëmijët poashtu mund të sjellin libra apo revista edhe nga shtëpitë e tyre.

Ky koleksion nuk është patjetër të ndërlidhet me temën që punohet-mësohet.

Para se të fillojmë me kryerjen e detyrës, patjetër duhet të hapet diskutim para nxënësve:

-si une e kuptoj të drejtën konkrete?

-cilat ngjyra i përgjigjen?

-ni çka mi asocon kjo e drejti?

Disa kishilla:

Nise planifikohet qi ekspozita ti jeti ni shkollë, apo në tjetër shtëpi me karakter publik, nxënësit duhet të harmonizojnë cilësitë krijuese rreth dizajnit si:madhësia e letrës, shkronja dhe stilit të tyre.

Lejoni nxënësit të ndihmohen mes veti. Në raste të këtilla, lejoni kohë pune shtesë ose jepuni detyra shtëpie.

Mos u hamendni se a duhet t’ju caktoni detyra shtuese, nxënësve veçanerisht të talentuar. Mund të ftoni artist nga mjedisi lokal, për ti dhënë klasës inspirim dhe përkrahje.

Mendoni me kujdes, se a doni të organizoni gara dhe shperblime për detyrat më mire të punuara dhe të dalluara..

A kishit propozuar që të ftoni nje gazetë lokale për të shkruar një raport me fotografi?

Ajo që dua, a është ajo që më duhet?**Plani operativ**

Etapat-fazat	Pyetjet kryesore/përmbajtjet	Detyra kryesore	Materiale
Mësimi-leksioni 1	Cilat janë dëshirat e mia?	Me atë që sqarojnë mes veti, fëmijët bëhen të vetëdijshëm për dëshirat e tyre.	Fotografi për formimin e çifteve
Mësimi 2	Çka ju duhet njerëzve? Çdo të ishte bukur të kihet?	Fëmijët mund të dallojnë dëshirat dhe nevojat e tyre dhe nevojat elementare për kënaqësi personale.	Detyrë shtëpie: Nxënësit mbledhin -revista të vjetra, -gërshërë për çdo nxënësi, në grup. -ngjitese, -fl. të zbraza Kovertë letre të madhe, -litar, konop-4m. -10 veshje dhe kapëse për to.
Mësimi 3	Ç'janë dëshirat? Ç'janë nevojat?	Të udhëhequr sipas ndonjë kriteriumi, fëmijët pajtohen për 10 dëshira dhe nevoja më të rëndësishme.	Materialet e siguruara nga fëmijët.
Mësimi 4	A përputhen të drejtat e fëmijëve me atë që duam dhe ate që na duhet?	Fëmijët i krahasojnë idetë e tyre dhe bëjnë prezentimin e postereve në ditën ndërkombëtare të fëmijëve.	Kopje nga konventa e te drejtave të fëmijëve për çdo grup; Hamer-flipçart

Qëllimi arsimor:

Më qëllim që të kuptohen të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut dhe çka paraqesin ato, nxënësit fokusohen në navojat dhe dëshirat e tyre. Patjetër duhet të bëhen të vetëdijshëm për atë se ç'farë presin nga jeta në rastin konkret të tyre. Si hap i parë, duhet të mendojnë për dëshirat dhe nevojat, pa marrë parasysh sa janë çmenduri apo të pamundura, te njejtat ti tregojnë.

Si hap i dytë; duhet të përcaktojnë dallimin mes dëshirave dhe nevojave të realta në jetë.

Ky aktivitet me siguri se nxënësit do ti bart nëpër të drejtat e shumta të konventës.

Është me rëndësi që në çdo hap arsimtari të stimulon dhe udhëheq diskutimin, me tendence të imponojë norma dhe vlerat personale.

<i>Pyetjet kryesore për refleksion në orët e të drejtave të fëmijëve</i>		
<i>Për</i>	<i>përmes</i>	<i>Për shkak-pse</i>
<i>A r s i m t a r i</i>		
Ç'farë dinjnë tani fëmijët për të drejtat e fëmijëve?	Në ç'mënyrë vëzhgohen principet e të drejtave të fëmijëve në orë dhe bashkësinë shkollë?	Mësim-si të ndërmeret aksion jashtë shkollës ;cka mësuan nxënësit për të ardhmen e jetës së tyre?
	Kjo temë ju ofron nxënësve mundësinë për të shprehur dëshirat dhe nevojat e tyre. Mësojnë se dikush i dëgjon dhe seriozisht i kupton ata.	Fëmijët duhet të kuptojnë se për cdo ditë ndeshen me pyetje të rëndësishme në raport me jetën dhe se shoqëria ka krijuar kushte jo të njejta për anëtarët e saj gjatë ballafaqimit me problemet.
<i>Nxënësit</i>		
Cka mësova për të drejtat e fëmijëve?	Si i perjetova drejtat e fëmijëve në orë?	Cfarë lloj të aksionit jam i aftë të ndërmarë tani?
Mësova se të drejtat e fëmijëve janë te fokusuar në nevojat tona më të rëndësishme – pjesëmarrje, zhvillim ,ekzistencë dhe mbrojtje dhe se janë shumë të lidhura me jetën time të përditshme .	Mund ti shprehi dëshirat e mia vetëm nëse ju besoj arsimtarit dhe bashknxënësve të mi.	Do të tentoj të kujdesem më shumë në dallimet mes dëshirave dhe nevojave . Nuk do të fshehi apo mohoj dëshirat apo ëndrat e mia dhe se do të mundohem që ti realizoj duke pasur parasysh që të mos çënoj nevojat e të tjerëve.

Materiali i nevojshëm:

Kartolina me të drejtat e fëmijëve;
 Gjësende-mjete të siguruar nga nxënësit;
 Revista të vjetra me shumë fotografi;
 Gërshërë për cdo nxënës ;
 Ngjitese;
 Disa letra të zbrazëta;
 Zarfë letre të madhe,
 Litar – konop – 4m.
 10 paketime prej veshje.

Rjedha e orës mësimore-proçedura

Mësimi-leksioni 1

Arsimtari pret në 4 pjesë disa fotografi të veturave luksoze, përgaditja të modës apo pushimoreve tërheqëse dhe sipas zgjedhjes së rastësishme ua ndan nxënësve.

Nxënësit pa tjetër duhet të gjejnë shokun-partnerin e tij i cili poashtu mban-ka pjesën tjetër të së njejtës fotografi. Së bashku formojnë grupin. Numri i pjesëve të prera të fotografive, arsimtari në mënyrë përkatëse riaftëson nxënësit sipas numrit të tyre në grupe (pjesët e prera të fotografive të përputhen me numrin e nxënësve).



Disa ide për ti motivuar grupet :

Grupet zgjedhin zëdhënësin-spikeri dhe menaxhuesit – udhëheqësin.

Zëdhënësi do të flet për grupin para të tjerëve dhe arsimitareve.

Ai apo ajo është përgjegjës për bartjen e mendimit të grupit e jo mendimin e vet.

Menaxhuesi-udhëheqësi organizon procesin e punes, i integron-përfshin të gjithë anëtarët dhe përkujdeset për orarin e kohes.

Cilat dëshira mund ti mbajnë në mend nxënësit?

Cilat ishin dëshirat e tyre më të fuqishme kur kanë qenë më të vegjel?

Cka i ka bërë ata shumë të gëzueshëm në moshën 7-10 vjecare?

Cka vërtet do ti bënte të gëzueshëm tani?

Cilat dëshirat i dine i kanë të rriturit?

Grupi nxhet fotografinë e tyre në letër dhe shkruan dëshirat-të ndara sipas moshës.

Pajtohen reth emërimit-caktimit të titullit .Grupi i prezenton rezultatet në klasë.

Mini posteret vendosen – varen në klasë .

Për javen e ardhshme nxënësit marrin detyra:

Secili grup duhet të sjell materialin punues,si vijon:

Disa revista të vjetra me shumë fotografi,

Gërshërë për cdo nxënës

Ngjitëse

Disa fleta letrejanë zbrazëta

Zarfë letre të madhe

Litar konop 4m

10 paketime prej veshje

Mësimi –leksioni 2

Nxënësit vazhdojnë së punuari në grupe.I disktojnë pyetjet në vijim:

Cka kishim dashur të kemi ?

Cka na nevojitet urgjentisht?

Në cifte nxënësit i shiqojnë-shqyrtoje revitat dhe materialet tjera. Kur do të gjejnë fotografitë që simbolizojnë dëshira dhe nevoja jo materiale, i presin dhe i tubojnë-mbledhin.

Secili çift mbledh afërsisht 10 fotografi duke i mundësuar cdo grupi nga 20 fotografi.

Fotografitë emërohen prej numrit 1-20.

Grupi bën listë me të gjitha fotografitë dhe dallon 2 nivele të dëshirave dhe nevojave:

Niveli bazë	Kënaqësia personale
Futboll,	Shokë-miq
Vetur	Fat
Shtëpi	Prindër
Ushqim i mirë	Shëndet

Niveli bazë-themelore dhe niveli më i lartë i kënaqësis

ë personale.

Lista mund të ketë këtë pamje:

Mësimi-leksioni 3

Grupeve u jepet detyra si vijon:

Zgjidhni 10 fotografi që paraqesin dëshirat tuaja më të rëndësishme.

Procedura është si vijon:

Fotografitë e emëruara me numra vendosen në tabelen e grupit, secili anëtar i grupit mund të ndajë 10 pikë-poena. Këto 10 pikë jepen për të zgjedhur 10 fotografitë, ekziston mundësia për disa fotografi të ndahen edhe nga 2 pikë.

Cdo nxënës bën listë të fotografive dhe poenave të ndarë. Ata fotografi me rezultat më të lartë – janë më të këndshme-për grupin.

Grupi i fikson fotografitë e tyre në litar-konop duke i vendosur në këtë mënyrë:

Në të majtë – fotografitë të cilat paraqesin gjëra që na nevoiten për jetë dinjitoze (nevojat themelore);

Në të djathtë-fotografi të cilat paraqesin gjëra që na nevoiten për të qenë të kënaqshme.

Mësimi-leksioni 4

Grupi vazhdon se punuari me këto materiale :

10 fotografi të zgjedhura

10 flete letre me madhësi A3

Konventa për të drejtat e fëmijëve(2 verzionet)-për cdo nxënës

Detyra

Lexoi të gjitha të drejtat e fëmijëve në zë - brenda grupit(sipas radhës)

Cilat të drejta ju përkasin-cilave nevoja.

Pergaditni 10 postera.

Ngjit nga një fotografi në cdo copë letre duke shfrytëzuar anën e majtë;

Në anën e djathtë plotëso të drejtat e fëmijëve që ju përkasin dëshirave ose nevojave sipas pyetjes.

Shëno sqarimin për lidhshmërinë në mes fotografive, dëshirave dhe nevojave dhe të drejtave të fëmijëve.

Shiqo shembullin e mëposhtëm:

Vendi për fotografinë tënde	Neni 7 Emri ynë dhe nacionaliteti
Vendi për fotografi	Me të lindur kemi të drejtë të fitojmë emër, nacionalitet dhe nëse është e mundur të jemi nën përkujdesjen e prindërve. Neni 8 Ruajtja e identitetit tonë. Kemi të drejtë ta mbrojmë dhe mbajmë emrin tonë, nacionalitetin dhe lidhjet familjare. Neni 10 Bashkimi familjar Nëse nevoitet të hyjmë apo lëshojmë ndonje shtet për të qenë përsëri të bahkuar me familjen tonë qeveria mban përgjegjësinë që të ballafaqohet-meret me rastin tonë, shpejtë dhe në mënyrë humane, gjithashtu nëse prindërit tonë jetojnë në shtet tjetër kemi të drejtë për kontakt personal dhe drejtperdrejt me to.

	Nëse cdokush pajtohet, dakordohet, të gjithë posterat do të ekspozohen në mesin e shkollës me rastin Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve (20 Nentori)
--	---

Ora 8

Vet bëj poster!

Plani operativ

Etapat-fazat	Pyetje kryesore/permbajtja	Detyra kryesore	Materiale
Mësimi- leksioni 1	A i kuptojmë nenet e të drejtave për fëmijë?	Nxënësit zgjedhin nene nga konventa për mësim të mëtejshëm me të thelluar, sipas kriteriumeve të caktuara gjatë dy leksioneve në vijim.	Shembuj nga konventa e të drejtave të fëmijëve.
Mësimi 2	A e kuptoni kriteriumin? Si është e mundur që arsimtari të përkrah, pa intervenim presion fizik?	Nxënësit punojnë, në grupe të vogla, sipas tempos së tyre. Analizojnë nene dhe nga Konventa dizajnonë diagrame.	Letër, revista, ngjithëse, gërshërë
Mësimi 3	Çka mësuam? Sa ishte e komplikuar detyra jonë? Si e shfrytëzuar lirinë tonë?	Nxënësit ndikojnë në procesin e punës së tyre dhe diskutojnë –si ti ekspozojnë prodhimet-punimet e tyre.	Posterat finaltë përzgjedhur.

Qëllimi arsimor: Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve do të mbeteshin verzion shterp, të shkruara vetëm në letër, po që se nuk do të fitonin rëndësinë konkrete në jetën e një personaliteti. Prandaj ato patjetër duhet të lidhen me përvoja konkrete, do të thotë, doemos të aplikohen në jetën e përditëshme dhe se shkëlja e tyre patjetër duhet të identifikohet. Por, vetem hapi i parë ,mer kohë të mjaftueshme.



Që nxënësit ti kuptojnë rregullat, ata duhet patjetër me to të punojnë. Këtu duhet përmendur dhe sqaruar termi-nocioni “të drejta të fëmijëve” sepse shpesh herë nxit iritimin mes adoleshentëve. Në fjalë - ata nuk dëshirojnë të quhen-emërtohen fëmije. Por këto të drejta ju përkasin edhe atyre-përderisa arrijnë moshën 18 vj. Adoleshentët duhet të kuptojnë se të drejtat e fëmijëve ju sigurojnë instrument i cili do të ju ndihmonte në rast padrejtësie ose të kerkuarit e drejtesisë.

Qëllimi i këtij projekti është të organizohet ekspozitë - nëse është e mundur me 20 nëntor, me portofolje (poster) me të gjitha të drejtat e fëmijëve. Çdo portofolje përmban elementet përshkruese të përmbajtjes, analizë dhe ilustracion, thirrje për lloje të ndryshme qasjeje, nga ajo analitike deri te ajo kreative.

Nga aspekti didaktik, kjo ekspozitë mundëson rastin për tu ballafaquar me nen të caktuar nga Konventa. Ndoshta arsimtarët e klaseve tjera, mund t’ju shërbejnë si “porote”(komision), që do të zgjedhë portfoljen më të bukur, i cili do të shpërblehet me dhuratë simbolike, si p.sh.biletë për kinema, teatër,”vauçer”për libër,etj.

Shembujt nga jeta e përditshme ose me kontekst internaconal, duhet të meren nga medime të ndryshme të shtypura, të cilat nxënësit i kanë sjellur në shkollë.

Prandaj, leximi i revistave dhe librave do të jetë bërthama për përgaditjen e kësaj detyre. Pa punën në grupe, nxënësit nuk do të kishin arritur qëllimin e tyre.

Projekti do të duhej të zgjase përafërsisht , aq sa është e nevojshme për realizimin e 4-ër përmbajtjeve mësimore. Lexuesi mund të vërejë se çdo përmbajtje mësimore nuk mbaron në veçanti, por të gjitha së bashku formojnë një tërësi.

Brenda grupit, nxënësit duhet të dijnë vete të krijojnë “kornizë kohore”të vehten.

<i>Pyetjet kryesore për refleksion në orët për të drejtat e fëmijëve</i>		
Për	përmes	përshkak
<i>A r s i m t a r i</i>		
Çfarë dijnë tani nxënësit për të drejtat e fëmijëve?	Në çmënyrë vëzhgohen principet e të drejtve të fëmijëve në klasë dhe bashkësi shkollore?	Mësimi - si të ndërmeret aksion jashtë shkollës? Çka mësuan nxënësit për të ardhmen e tyre?
Nxënësit mësojnë si të analizojnë të drejtat e fëmijëve përmes qasjes sistematike.	Fëmijët klasën dhe shkollën e shiqojnë si një mjedis stimulues për jetë. Gazetat ditore shëndrohen në material pune. Në këtë mënyrë shkolla bëhet vend ku nxënësit mund të shiqojnë në përditshmërinë e jetës së tyre.	Përmes mësimin se si prezentohet prodhimi (portfolio) nxënësit vetëdijesohen për vëzhgim dhe prezentim të punëve të rëndësishme edhe jashtë shkollës.
<i>N x ë n ë s i t</i>		
Çka mësova për të drejtat e fëmijëve?	Si i përjetova të drejtat e fëmijëve në orë?	Çfarë lloj aksioni jam i aftë të ndërmar tani?
U bëra i vetëdijshëm se sa nenet nga Konventa janë frazuara dhe sa aspkte të fshehta ka në to. Mësova si ti analizojë dhe mendoj për to.	Vërejta se sa arsimtari dhe bashkënxënësit e mi, me inkurajojnë por edhe “sprovajnë njëkohësisht. Dy llojet e interaksionit janë përkrahje e llojit të vet për mua.	Jam i gatshëm të mar pjesë në debate publike për temat që i kuptoj. Jam i gatshëm të them mendimin tim për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njerëzve, gjithashtu të degjoj se çka kanë për të thënë të tjerët.

Materiali i nevojshëm:

- Fl.letre të mëdha,
- letër me ngjyrë ,
- stilolaps,
- gërshërë,
- ngjitëse,
- revista dhe gazeta të vjetra,
- vizatime dhe fotografi,
- tekst nga Konventa e të drejtave të fëmijëve,
- kartolina me të drejtat e fëmijëve.

Rrjedha e orës mësimore – procedura

Mësimi – leksioni 1 - 3

Së pari, arsimtri ua prezenton nxënësve planin e tërësishëm të 4-ër përmbajtjeve mësimore në vijim. Klasa duhet kuptuar se duhet të krijojnë portfolio-poster, me të cilat tregohen të drejtat e fëmijëve, duke kyçur mundësinë për gara.

Nxënësit duhet punuar në grupe me nga tre nxënës. Mënyra se si duhet organizuar e gjithë kjo, është e dhënë më poshtë.

Konventa për të drejtat e fëmijëve përmban 54 nene, prej të cilëve të parët, prej 41-42 janë më të rëndësishëm dhe direkt të lidhur me nxënësit. Pa dallim se çfarë selektimi do të bëjë arsimtari, është më se e qartë se nxënësit do të punojnë më shumë nene se një.

Në fillim gjithë nxënësit duhet të lexojnë Konventën dhe të bëjnë zgjedhje personale të 3 neneve për të cilët mendojnë se janë më rëndësi të veçantë për to. Sipas rendit numerik kartelat prej letre me të drejtat, janë vendosur në tabele. Nxënësit i zgjedhin të dejtat e tyre “favorite” me tërheqjen e një vije të shkruar deri të kartelat përkatëse.

Pastaj arsimtari i nxit nxënësit të këmbajnë mendime, duke i siguruar ata, qe secili të ketë mundësi për pjesëmarrje dhe të jetë i dëgjuar.

-Si reflektohet “zgjedhja e prioritetve” në situata reale të fëmijëve dhe adoleshentëve?

-A mund të identifikosh “skemën” e principeve nga prapavija?

-Cilat elemente janë lënë në prapavijë?

Tani duhet të formohen grupet, e ajo mund të bëhet se paku përmes 3 mënyrave,-arsimtari duhet të zgjedhë, se si?

1.Grupet mund të zgjidhen sipas rastit.

2.Nxënësit vet mund të zgjedhin partnerin-çiftin.

3.Arsimtari vendos ,si do të jenë grupet. Ai duhet menduar që kriteriumi të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, për të gjithë nxënësit.

Para se të fillohet me punë, grupet patjetër duhet të jenë të organizuara. Nxënësit i emërojnë grupet dhe paraqesin 3 detyra. Çdo grupi i nevojitet udhëheqës - menaxhues për kohën, për materile dhe koordinator. Grupi shënon të gjitha përgjigjet e anetareve të grupit të vet. Këto plane pune, vihen në klasë. Më pas grupet do ti udhëzojnë anëtarët në detyra që kanë para vehtes, për të kryer. Definimi i roleve në mënyrë të këtillë nuk nderlidhet me ate që nxënësit do të punojë, por kjo do të përmbajë në zhvillimin e aftësive sociale dhe aritjen e qëllimeve të tyre.

Ndërkohë,arsimtari ka bërë zgjedhjen 10 neneve,më shpesh të zgjedhura nga tabela dhe në anën e kundërt i vendos në tavoline.

Secili grup përgadit portfoiol për të drejtat e fëmijëve

Portfolio përbëhet nga:

-titullin që e jep e drejta e fëmijëve,

-tekstin e nenit nga Konventa për të drejtat e fëmijëve,

-vizatim-fotografi që simbolizon të drejtën e fëmijëve,

-shkrim nga revistë apo gazeta, që i dedikohet ti drejtës dhe sqarim se është ndërlidhur neni me shkrimin e revistës apo gazetës.

Pas përfundimit të portfoljes ,grupi do të zgjedhë tjetër nen, nga nene-t e mbetura dhe do të bëjë edhe nje portfolio tjetër në të njejtën mënyrë.

Grupet punuese ,studiojnë detyrën e tyre:vendosin listë të materialeve të duhura dhe të pyetjeve për të cilat mund të lindin.

Pastaj grupet dakordohen me planet e tyre. Çka duhet të bëhet - ndreqet? Çka patjetër,duhet mbledhur?Çka mund të sjellë, ndonjë anëtarë i grupit, nga shtëpia? Si menaxhuesi për kohën e përpilon orarin? Ku do të jenë të vendosura materialet?

Nëse arsimtari më herët i ka planifikuar përmbajtjet mësimore, atëherë ai na jep detyrën disa javë më parë, për të mbledhur revista dhe gazeta, si detyrë shtëpie, për projektin në fjalë.

Gjatë fillimit të aktivitetit të grupeve,arsimtari duhet ti thëret nxënësit në sesion për refleksion dhe informata kthyesë. Pyetjet në vijim mund të ndihmojnë:

-Çka u punua mirë?

-Ku na duhej ndihmë?

-A i kuptuam funksionet tona ,brenda grupit.

Arsimtari gjithashtu duhet të bisedojë me nxënësit edhe rreth ekspozites. Ku dhe kur duhet mbajtur? Kush do të shpall të hapur? Kush do të jetë i ftuar në ceremoni? Kush do të jenë anëtarë të komisionit-“porota”?

Mësimi –leksioni 4

Në fund të projektit, gjegjësisht pas përfundimit të portfoliove, gjithë klasa së bashku me arsimtarin duhet ti kthehen - përvishen punës së tyre. Sejcili grup e prezenton portfolion e vet në klasë. Tani është momenti të sqarojmë se si është situata e sotme mbi të drejtat e fëmijëve.

-Çka duhet patjetër të ndërmeret në përmirësimin e situatës?

-Cilat janë mundësitë tona?

-Si duhet të informojmë, e cilin duhet kyçur?

Nxënësit gjithashtu duhet të vendosin se ku duhet ruajtur portfoliot. Ndoshta duhet mbajtur një ekspozitë speciale, me 20 nëntor - Diten Ndërkombëtare të Fëmijëve, në kuvendin e qytetit apo ndonjë organizate joqevritare.

Ora 9

Pse patjetër duhet të respektojmë rregullat?

Plani operativ

Etapat	Pyetje kryesore/përmbajtja	Detyra kryesore	Materiale
Faza përgaditore	Nxënësit mbledhin informatë, ku është shkelur ndonjë rregull shkollore.	Punë e pavarur: Mbledhja e informatave	Tabelë faktesh e standardizuar
Mësimi – leksioni 1	Nxënësi në situatë të pa voliteshme (studim rasti)	Punë në grupe: Analizimi i rastit	Tabelë pune për studimin e rastit
Mësimi 2	Pse shkolla ka rregulla?	Puna në grupe: Kontrollimi i rregullave shkollore - shqyrtimi i tyre, nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve.	Flipçart dhe tabelë pune: Pse shkolla ka rregulla? Shembuj nga

		Detyrë shtëpie: Cilat rregulla e udhëheqin përditshmërinë tonë.	rregullat shkollore. Tabelë punë: Cilave rregulla ju nënshtrohemi gjatë ditës?
Mësimi 3	Ku janë të nevojshme rregullat në sete?	Punë në grupe: Kush i sjell e kush i lejon (ve në fuqi) rregullat “joformale?	
Mësimi 4	Kush duhet vendosur ligjet? (rregulla për sjellje të ligjeve)	Punë në grupe: Cilat rregulla sigurojnë drejtësinë e ligjeve?	
Vazhdim	Vijon diskutimi me drejtorin apo pedagogun e shkollës.		

Qëllimet arsimore

Shkolla është jete - rregullat shkollore kanë qëllim-cak të drejtat sikur ligjet në shoqërinë politike, kjo do të thotë është të mbrohen të drejtat njerëzore.

Mësimi nga përvoja- mësimi përmes shembujve (konkret).:

Paralelja mes rregullave shkollore dhe ligjeve në bashkësinë politike:

- Asnjë shoqëri nuk mund të ekzistojë pa pëlqimin mes neneve, për respektimin e ndonjë rregulle
- Ligji i mbrohet të pamundurit (dobjtit). Ligjet janë e instrument për aplikimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve.
- Ligjet do të funksionojnë vetëm nëse në globale janë të kuptueshme dhe të çmuara-vleresuara. Andaj ato duhet të jenë, “ferë” qëllim mirë.

Dallimet mes shkollës dhe shoqërisë politike:

- Krijimi i ligjeve dhe fuqizimi i tyre është ushtrim i “forcës”- fuqisë”.
- Forca –fuqia duhet kontrolluar. Prandaj ligjet duhet të plotësohen me të drejtat e njeriut, kurse fuqia e krijimit të tyre duhet ndarë dhe kontrolluar në shoqërinë demokratike.
- Në shkollë përgjegjësia për definimin e rregullave është - gjendet te drejtori dhe të punuarit në shkollë. Sidoqoftë rregullat shkollore duhet të jenë të hapura për diskutim në kuptimin relacionin të Drejta Të Fëmijëve, kurse nxënësit duhet të kuptojnë dhe cmojnë nevojën për to (rregullat shkollore).

Pyetjet kryesore për refleksion në orët për të Drejtat e Fëmijëve		
Për	Përmes	Për shkak
A r s i m t a r i		
Çfarë dijnë tani fëm-nxën. Për të drejtat e fëmi..?	Në çmënyrë vëzhgohen principet e të drejtave të fëm. Në klasë dhe bashkësinë shkollore?	Mësimi si ndërmeret aksion jashtë shkollës. Çka mësuan fëm-nxë. Për të ardhmen e jetës së tyre?
Të drejtat e fëmijëve janë pjesë e ligjeve shtetërore dhe si e tillë janë obligues për çdonjërin. (Krahas saj) askund në botë nuk janë plotësisht të implementuar (fatkeqësi)	Nxën. mësojnë si të ballafaqohen me shpërndarjen jo të barabartë të fuqisë? I shfrytëzojnë të drejtat në favor të tyre, por kuptojnë se ka kufije në atë që mund të arrijnë.	Për nx. Kjo është një përvojë e rëndësishme sepse do tju ndihmojë; si të ritur të ballafaqohen me peshën- vështirësitë gjatë “bisedimeve” apo humbjeve politike.
N x ë n ë s i		
Çka mësova për të drejtat e fëm.	Si i përjetova të drejtat e fëm. në orë?	Çfarë lloji të aksionit jam i aftë të ndërmarë tani?
(e_ di se të drejtat dhe obligimet janë të patjetërsueshme për jete në bashkësi.	Mësova të tejkalojë procesin e rëndësishëm të bisedimeve dhe marveshjeve të drejtave dhe obligimeve. Mësova se si duhet të ballafaqohem me frustracionet dhe humbjen.	I diskutoj të drejtat dhe obligimet duke shfrytëzuar-përdorur dijen-njohuritë e mia. Mund të komunikoj, “bisedoj dhe debatoj - (mbroj qëndrime) me përfaqësues autoritativ si dhe ti dëgjojë- përcjell ato.

Qasja didaktike

Njësitë mësimore janë të përgaditura në bazë të skemës- zgjërimit i rrateve koncentrike. Përmbajtja-mësimi, kryhet përmes një incidenti specifik kur thyhet-cenohet një rregull. E dyta përmes pyetjes se cili është qëllimi i rregullave shkollore , me qasjen e vet pyetjes, ofron përgjigje se rregullat janë vegël e mirë për funksionimin e mirë të shkollës në pajtim me të Drejtat e Fëm. Përmbajtja mësimore IV bën diferencim mes rregullave dhe ligjeve dhe (tërheq vërejtjen) mëson se kush e ka fuqinë për të krijuar dhe implementuar ligje, të cilat, ne jemi të obliguar ti respektojmë.

Përgatitja e aktiviteteve

Reth një javë , para fillimit të realizimit të përmbajtjes së parë mësim.

Përmbajtja mësimore e parë:

Arsimtari ua jep detyrën nxën: Nxën të mbledhin informata rreth rastit jo të largët, ku është thyer rregulla shkollore, në të cilën nxën. ka qenë i dënuar.

Ata nxën. duhet të mbajnë shënime me ndihmen e një pyetësi të shkurtë të standardizuar.

Materiale të nevojshme:

Tabelë e standardizuar në fakte.

Pyetje kryesore: *Çka ka ndodhur? *Kush ishte ë përzier? *Çfarë dënimi i është dhënë?(nëse i është dhënë)?

Mësimi –leksioni 1: Nxënësit në fatkeqësi (gjendje të padëshiruar)-(studimi 5 i rastit)

Mënyra e të ulurit : Nxën ulen në tavolina për punë në grupe.

Njohja me detyrën: Disa nxën japin informacionet e tyre lidhur me rastin në fjalë.

Tani klasa duhet të identifikoj rastin. Arsimtari i inkurajon-trimëron nxën. që të tregojnë – shpjegojnë komentet e tyre. Së paku 5 opo 10 nxën. duhet të fitojnë mundësinë për pjesëmarrje. Mvaresisht nga rasti, vështrimet e tyre mund të jenë kontraverze ose të pajtohen me tërë atë që ka ndodhur (p.sh Mendoj se dënimi i shqyrtuar “nuk ishte –ose ishte i drejtë”)

Arsimtari lut që ndonjëri nga nxën. ti mledh- tuboj këto komntime ose të bëjë vet atë?

-Të paramendojn , sa për demonstrim , se rasti ka të bëjë me nxën. i cili shpesh herë është vonuar për në shkollë- në mëngjes, dhe pasi arsimtaret kishin biseduar disa herë me të, atij i ishte dhënë dënimi.

Komentet e nxën. mund të jenë nga disa aspekte:

-Shkolla mund të funksionojë drejt vetëm, nëse të gjithë e respektojnë orarin e kohës

-Sjellja e nxën.–vonesa e tij; jo vetëm që dëmton interesat e veta , por edhe të tjerëve.

-Ndoshta nxënësi ka arsye personale për sjelljen e këtillë dhe atij i është e nevojshme ndihmë, e jo dënim!

Anëtarët në grupe duhet ti ndajnë informacionet e tyre, ti shkruajnë dhe diskutojnë ato-në veçanti pyetjet konkrete 4 dhe 7, sepse çojnë në esencën e rastit.

Prezentues të grupeve duhet ti dorëzojnë përgjigjet e ketyre 2 pyetjeve. Mbejta e orës është paraparë për këtë detyrë.

Prezantimet do të mbahen –bëhen në fillim të leksionit të dytë.

Pyetje –Shqyrtimi i rastit të 5-të. Nxënësi në situatë të padëshiruar-fatkeqësi-në shkollën tonë.
1.Çka ka ndodhur?
2. Kush e zbuloi apo theksoi rastin ?
3.Kush është përzier?
4.Ç’është problemi? (sepse duhet doemos-patjetër) të mbrohet jeta dhe puna në shkollë?
5. Cilat rregulla shkollore praktikohen në këto raste?
6. Cili dënim-cila gjë ishte shqyrtuar?
7.Çfarë efekti ka dënimi tek nxën. e tjerë?

Kuptohet tabela mund të modifikohet –vazhdojë nëse është e nevojshme.

Mësimi –leksioni 2 : Pse shkolla patjetër të kete regulla?

Sqarimi dhe thjeshtësimi i rastit: Për çfarë problemi bëhet fjalë?

(Spjegim dhe dialog hyrës)

Leksioni fillon me prezantimin e grupeve të nxënësve të cilat zhvillohen gjatë dy fazave:1 së pari prezantohen përgjigjet e pyetjes 4 (cili është problemi që qëndron nën sipërfaqe- në kuptimin ende i paqarte i fshehur-respekt jo I dëshiruar)

2 Së dyti prezantohen përgjigjet e pyetjes 7 (Si ndikon dënimi tek nxën. tjere. në kuptimin esencial (si të ndryshojmë situatën në të mirë të të gjithëve)

Nxënësit duhet të dëgjojnë me kujdes. Detyrë e tyre është të vendosin-gjykojnë me të cilat aspekte të rastit pajtohen e me cilat jo?

(Në fazën e radhës) nxënësit tregojnë shprehin mendimin e tyre lidhur me prezantimin. Arsimitari korigjon ose jep informacione plotësuese apo mendime, nëse është e patjetërsuar. Pas këtij ushtrimi nga nxën. pritet të kuptojnë se jo vetëm në rastin e nxënësve që vonon , po në globale , tërësi gjithë ne gëzojmë përjetojmë të drejta themelore njerëzore dhe qytetare të cilat njëherit patjetër duhet të respektohen në shkollë.

Që të arrihen këto të drejta në shkollë disa kushte doemos duhet vëzhguar.

Arsimitari duhet tu përcjellë nxën. porosinë se: shkolla është vend, ku shumë njerëz të rinj dhe pleq njoftohen dhe punojnë së bashku.

Kjo duhet të jetë e organizuar, që kuptohet, nënkupton disa rregulla siç është edhe ajo se ligjerata-spjegimi i mësimëve fillon dhe mbaron në kohë së bashku me arsimtarin i cili është (prezent) në klasë.

Edhe me e rëndësishmja shkolla shërben për implementimin e të drejtave sh. Të rëndësishme të fëmijëve dhe adoleshentëve- e drejta për arsimim (neni 28,29)

Arsimitari këtë nuk duhet tua spjegojë nxënësve. Ata e dinë se shkolla në këtë mënyrë funksionon. Ata ndoshta edhe nuk janë të vetëdijshëm se kanë këtë të drejtë (për arsimim), por saktësisht dinë se pse duhet shkuar në shkollë, dhe si duhet të funksionojë mirë shkolla.

Pastaj arsimtari mban ligjeratë të shkurtër për të drejtat e fëmijëve të cilat janë me rëndësi të veçantë për jetën në shkollë.

Gjatë përmbajtjes mësimi-shfrytëzohet “flip-kartë” tabela; si shembulli i tabelës punuese që do të shfrytëzohet nxën. në detyren që vijon, e dizajnuar kështu:

-Pse shkolla ka rregulla?	
-Të drejtat e fëm. Dhe adoleshentëve (konveta e vitit 1989)	Cilat rregulla në shkollë janë në shërbim të këtyre të drejtave?
-Neni 13: liria e të shprehurit.	
-Neni 14: liria e mendimit, vetëdijes dhe religjionit	
-Neni 24: E drejta për kujdes shëndet	
-Neni 28:E drejta për arsimim, fillor, të mesëm, superior, dhe masat për vijim të regullt në shkollë.	
-Neni 31 :E drejta për pushim dhe kohë të lirë.	
-Neni 33: Mbrojtja nga mjetet narkotike	
-Neni 37: Mbrojtje nga dhuna	

Leximi i rregullave në aspekt të të drejtave të fëmijëve:

Pse janë të vëna-krijuara këto rregulla?

Tani klasa largohet nga rasti dhe shqyrton rregullat shkollore nga një këndvështrim tjetër.

Arsimitari – në tabelë shënon idenë bazë të përmbajtjes mësimore:

Pse shkolla ka rregulla? Ai apo ajo nxën. u sqaron detyrën

-Nxën. formojnë grupe nga 3 apo 4 persona. Kjo detyrë zgjat 10-15 minuta.

-Arsimtari i jep-çdo nxën. rregull për rregullat shkollore.

-Sejcili grup mer flip –cart letër dhe folmaster-marker

Detyra e grupit është si vijon:

1.Në filim puno vet. Lexoju rregullat shkollore. Tento-mundohu të besh lidhjen (ku është e mundur) mes rregullave dhe të drejtave të fëmijëve.

2.Tani puno në ekip-tim. Shpërndaji idetë e tua dhe mundohu që të pajtoheni rreth asaj (që është esenciale) se cilat rregulla ju shërbejnë të drejtave të fëm.

Shënoni rezultatet.

3.Nëse asnje rregull nuk ndërlidhet me ndonjë të drejtë, lexoju dhe njëherë rregullat.

4.Emëro dy prezentues.

Derisa grupet punojnë, arsimtarët i vëzhgojnë ato edhe nuk duhet të komentojë apo korigojë gabimet e tyre.

Në 5 minutat e fundit të përmbajtjes mësimdhënësi-arsimtari, përqendron ngulit vemendjen e nxën. tek pyetja e shënuar në tabelë. Pse shkolla ka rregulla?

Nga fëm. priten përgjigjet si vijojnë: Shkolla shërben për të plotësuar të drejtën e fëm. per arsimtarin- rregullat shërbejnë që shkolla të funksionojë ashtu siç duhet, që të arrijë qëllimin e saj.

Nëse lejon koha, arsimtari mund të shkruaj konkluzen-konkludimin në tabele.

Si do që të jetë arsimtari insiston që fëmijët ti shkruajnë pyetjet dhe përgjigjen e tyre në fletore.

Tabela mund të ketë këtë pamje:

Disa ide fillestare –të parat	Pse shkolla ka rregulla?
Asgjë nuk funksionon pa rregulla. Gjithë kishin ardhur apo shkuar (në shkolle) kur të donin. Duhet t’na thuhet çka të bëjmë.	Gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë arsimimi. Rregullat shkollore janë të patjetersuara, për të garantuar , se ajo (shkolla) do të sigurojë edukimin më të mirë të mundshem.

Arsimtari ju jep nxën. detyrë shtëpie, si vijon:

(është kopje e tabelës punuese të sfhrytëzuar , në leksionin e mëparshëm)

Cilat rregulla duhet ti respektojmë gjatë ditës?

Zgjidh një ditë të javës.Shkruaj raport për këtë ditë, duke pasur parasysh, rregullat të cilat doemos-patjetër duhet ti respektosh.

Vështro-shiqo rregullat tregojne çka duhet bërë dhe si duhet të sillesh si p.sh.

-Kur je me familjen në shtëpi;

-Kur shihesh me shokët, miqte;

-Kur blene dicka në shitore, në market;

-Kur shëtit nëpër qytet.

Në situata tjera, tjera rregulla janë në fuqi-përdorim.

Vendos cilat rregulla janë të shënuara si formale gjegjësisht oficiale e cilat si rregulla të pashkruara –jo formale. Për shembull , rregullat shkollore janë formale –oficiale.

Rregullat që na thonë si të sillemi në tavoline apo kur jemi me familjen; janë jo oficiale-rregulla të pashkruara.

Koha	Rregulla	Formale-Jo fomale
...		
07.00		
08.00		
09.00		
10.00		
11.00		
12.00		
13.00		
14.00		
15.00		
16.00		
17.00		
18.00		
19.00		
20.00		
21.00		
22.00		
.....		

Mësimi –leksioni 3 Kush krijon rregullat në jetë?

Qëllimi :

Kjo përmbajtje posedon potencial të fuqishëm që nxënësit të trajtohen si EKSPERT, duke u mbështetur në përvojën e tyre, shiquar nga tjetër këndvështrim.

Arsimtari-lut nxënësit të lexojnë shembuj nga detyrat e shtëpisë. Ai ose ajo duhet të mundohet që nxënësit të lexojnë shembuj nga rregullat formale dhe jo formale.

Pastaj, arsimtari zhgjedh dy shembuj dhe ia bashkangjet tabelës, në matrice të thjeshtë; pëderisa e zhvillon matricën; e sqaron hapin në vijim;

Për demonstrim këtu janë shfrytezuar dy shembuj, por arsimtari mund të shfrytezojë edhe më shumë, nëse mendon që nxënësit të marrin rolin si ekspert.

Lloj rregulle vendosur në Prej...	Përmbajtja	Sjellur-aprovuar nga...
Rregull formale Shembull: ligji	Nuk guxon ta kalosh rrugën nëse është e ndezur drita e kuqe e semaforit.	
Rregull joformale	Nuk guxon të shtrihesh në tavolinë.	

Arsimtari i nxit nxënësit të tregojnë njohuritë e tyre.

Sidoqoftë, nxënësit do të hasin në vështirësi gjatë përcaktimit të asaj se kush i sjell rregullat joformale-të pashkruara. Në shembullin e cekur- paraprak, mënyra e të ulurit në tavolinë; mund të sqarohet se behet fjalë për „traditë”-dic që insistojnë prindërit dhe të moshuarit.

Disa nxënësve nuk ju pelqejnë rregullat, respektivisht përderisa ajo thyhet, ato do të ballafaqohen me ndonjë lloj dënimi.

Shiqar nga kjo prizme, gjithë ne luajmë role...Gjatë sjelljes së rregullave të pashkruara-jo formale.

Në kërkesë të arsimtarit, nxënësit formojnë grupe nga 4 apo 5 nxënës. ata kanë për detyrë „që nga fletoret e punës të rrëfejnë për shembujt e tyre të rregullave” joformale dhe të zbulojnë-ndikimi i cilit-kujt është më i madh gjatë sjelljes së rregullave joformale.

Pas 10 minutash, nxënësit japin raport-raportojnë mbi aktivitetin.

Rezultatet e tyre mund të jenë kështu; ndikimi i tyre është më i madh gjatë sjelljes së rregullave të grupit, kurse ndikim më të vogël, gjatë interaksionit me persona më të moshuar, si psh: Prindër ose arsimtarë gjithashtu nxënësit do të tregojnë se pranë rregullave joformale, gjegjësisht mos respektimin e rregullave mund të krijohet një rregull e re.

Në diskutimin përfundimtar nxënësit duhet të sjellin përfundim se bisedimet për përgaditjen e rregullave janë pjesë e mardhënieve aktive të qytetarëve në shoqëri (pjesemares).

Mësimi 4- cilit duhet ti lejohet të sjellë ligje? (rregulla për sjellje të ligjeve).

Arsimtari e fillon mësimin duke rikujtuar përfundimet e sjellura të nxënësve nga përmbajtja e mëparshme. Nxënësit i shqyrtojnë rregullat joformale dhe zbulojnë disa probleme gjatë sjelljes dhe aplikimit të tyre, gjithashtu, ata dhanë shembuj edhe të rregullave formale.

Në këtë ëesim për së afërmi do të njihen se si sillen ligjet.

Arsimtari jep shembull të shënuar në letër të madhe me flomaster me qëllim që të prezantojë më mirë para nxënësve në klasë.

Të gjithë meshkujt të lindur në prill nuk duhet të paguajnë tatime

Nxënësit lirisht mund të komentojnë dhe parashtrajnë pyetje haptazi. Idetë e tyre mund të fokusohen në vazhdim:

Ligji është jo i drejtë, është rënuar principi i jodiskriminimit. i diskriminon poashtu, edhe femrat e lindura në prill.

E qartë është se ligji është në shërbim të interesave të një grupi të vogël njerëzish-meshkujve të lindurë në prill .

Ligjet patjetër duhet të jenë në shërbim për të mirën e të gjithëve.

Prandaj ligjet e tyre patjetër duhet të ndërpriten –pezullohen.

Ligjet e padrejta, do të nxisin konflikte në shoqëri dhe mund të sjellin deri në shkatërrim .

Arsimtari i ndan nxënësit në grupe 4-5 nxënës në secilin grup.

I parashtron detyrë:

Nxënësit duhet të diskutojnë rreth asaj se cilat rregulla dhe principe janë të patjetërsueshme të cilat ofojnë mbrojtje kundër legalizimit të të drejtave.

Patjetër duhet të dakordohen në jo më shumë se 3 elemente kyçe-esenciale, në prezantimin e tyre të radhës.

Pas 10 minutash nxënësit i prezantojnë idetë e tyre.

Ata mund të dallohen në mes tyre ose të pajtohen mes grupeve.

Nxënësit duhet të dijnë se idetë e tyre nuk janë pjesë e jetës reale politike dhe se do të interesohen për atë se si sillen ligjet në shtetin e tyre.

Arsimtari përgjigjet në pyetjet e tyre duke dhënë shpjegime të shkurta.

Për demonstrim, informata themelore mund t duket kështu:

Kushtetuta përmban të drejta njerëzore, duke i kështur principet e ngjashme dhe lirisë personale.

Gjithashtu përmban pjesë rreth asaj se kush i definon ligjet;

Ajo është organ nga përfaqësues të popullit, i zgjedhur nga zëri i shumicës. Ata u nënshtrohen zgjedhjeve që do të thotë se janë nën kontroll të qytetarëve.

Vazhdimi

Nëse koha lejon dhe nëse nxënësit janë të organizuar, mund të angazhohen rreth rregullës shkollë, p.sh, se si do të aplikohen ose si do tju shërbejë të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Klasa mund të pregadit prezantim për diskutim me drejtorin ose pedagogun e shkollës.

Ky vazhdim u ofron nxënësve mundësinë për pjesëmarrje në jetën shkollë dhe të shijojnë si njohuritë e tyre mund të shfrytëzohen në situata nga jeta reale.

Pjesa e dytë

Informata plotësuese, dokumente dhe materiale për ligjërime

*“Por ajo do të thotë se kam të drejtë për pushim, apo jo?
Të drejtat e fëmijëve në klasë!*

Shembull: Nxënësit janë të ndarë në grupe. Bangat e tyre përdoren si tavolina për gjithë grupin, në të cilën janë vendosur kartolina me figura kafshësh. Në një tavolinë tjetër janë vendosur kartela-lepur, që nënkupton se nxënësit e këtij grupi janë paraqitur si lepuj, në tavolinën tjetër, kartela-ariu, kurse në kartolinën e tretë-tigrat.

Plotë shqetesim, një nxënës (lepur) e hap zarfën mbi tavolinën e vet. Arsimtari lut që të lexojë me zë të lartë, fjalitë e shkruara.

“Lepuri” lexon: “fëmijët kanë të drejtë në mbrojtje shëndetësore dhe përkujdesje shëndetësore”, në nivelin më të lartë. “Ka edhe numër”, thëret arsimtari. “Nuk zgjedhim aritmetik, por numri është i rëndësishëm!” Lepuri çohet dhe lexon “neni 24”. Arsimtari i është i kënaqur. Lepuri mund të vijë deri te tabela-para klasës. Neni 24 nga Konventa tregohet në pjesëz letre me ngjyrë, në formë balone (tullumbace), mund të varet në dërrasë.

Në dërrasë ka vend për shumë tullumbace. Së bashku ata do të paraqesin tullumbace me emrin “të drejta fëmijërore”. “Kjo është e drejta juaj”, ju drejtohet fëmijëve, dhe vazhdon, “Në të gjitha zarfet ka shume të drejta. Çdo e drejtë është tullumbace.” Fëmijet kanë kuptuar. Tani shumë duar janë të ngritura. Të gjithë lakmojnë të hapin zarfe, të lexojnë dhe të dalin para klasës, e të vjerin tullumbacen në dërrasë.

Kjo vazhdon në 45 minutat e ardhshëm. Tani është radha e “arrinjëve”. Më saktë ariut femër të brishtë. Në dorë ka Nenin 30. Lexon, “Fëmijët që i përkasin ndonjë grupi të pakicave kanë të drejtë të gëzojnë kulturën, religjionin, dhe të flasin gjuhën e tyre”. Kurse nga tavolina e tigrave dikush, plotëson: “Fëmijët kanë të drejtë në pushim dhe kohë të lirë, të drejta në lojë, dhe pjesëmarrje në jetën kulturore dhe artistike-Neni 31”

Nxënësit e klasës së tretë janë në gëzim, të entuziazmuar dhe disponim aktiv. Ka shumë levizje dhe pëshpëritje dhe secili dëshiron të jetë i dëgjuar.

*A është kjo mënyrë e mirë e ligjerimit-spjegimit?

*Mësim i mirë, për të drejtat e fëmijëve, apo?

*Si ju i mësoni fëmijët në të drejtat e fëmijëve?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet të jepen me shumë kujdes. Egzistojnë qasje të ndryshme metodologjike dhe kriteriume në të mësuar dhe prandaj nuk ka një definicion të vetëm për shpjegim të mirë. Megjithatë, të shtrojmë pyetjen: Si këto nene nga Konventa e të drejtave të fëmijëve, duhet të realizohen në procesin mësimor?

Në disa raste mund të shfrytëzohet metoda e të mësuarit, ku arsimtari është në qendër të vëmendjes, vetëm e vetëm se nxënësit janë mësuar në atë mënyrë. Si do që të jetë, kur bëhet fjale për përmbajtje nga sfera e të drejtave të fëmijëve, është e logjikshme që shpjegimi t ketë lidhje me nevojat dhe përvojat reale të nxënësve. Vetëm përkujtohuni në nenin 12 nga Konventa. Si ti mësoje nxënësit, se kanë të drejtë lirshëm të shprehin pikëpamjet e tyre dhe se për të gjitha punët e ndërlidhura me fëmijët duhet t’ju jepet peshë adekuate-konform

pikëpamjeve të tyre”?Dhe çka ndikon tek fëmijët dhe adoleshentët më shumë se arsimimi i tyre dhe shkolla?

Mësimi ndëraktiv

Për të drejtat e fëmijëve nuk duhet të sillemi sikur të jenë vetëm një copë letër, fjali që duhet mësuar përmendësh ose formula matematikore...por duhet të përdorim mësimin interaktiv. Metoda e shpjegimit-ligjerimit e bartë vetëm gjysmën e porosisë.

Nxënësit duhet të mësojnë:

- të kuptojnë të drejtat e fëmijëve (dituri),
- aktivisht ti praktikojnë të drejtat e fëmijëve (shkathësitë),
- të zhvillojnë vlera dhe qëndrime personale (qëndrime)

Në botën e shpjegimit dhe mësimin, 3 yjet: dituritë,shkathësitë dhe qëndrimet shërbejnë si udhëheqës të shumë gjeneratave të arsimtarëve. Shumë mirë janë të njohura,por shpesh injorohen. Shpjegimi shpesh bie vetem në një, nga këto tri kategori.

Dituria

Kuptohet se është e mençur ideja që fëmijët të dijnë për të drejtat e tyre. Mirëpo,kjo nuk do të thotë se duhet të njihen me ato, në menyr tipike dhe të bezdisshme, sikurse ato të jenë vetëm një pjesë letre. Fëmijët duhet të identifikojnë pyetje esenciale, të mbledhin informata dhe të analizojnë të njëjtat. Për të arritur këtë nxënësit duhet të diskutojnë për përvojat personale dhe të njëjtat ti lidhin me rregulla, koncepte dhe principe. Shkurt, ska dituri pa qartësi-qartësi...dhe nuk ka qartësi pa konstruktin - sistem aktiv të strukturave lidhëzore. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me të drejtat e fëmijëve, por çdo temë e cila mësohet.

Shkathësitë

Nxënësve u është e duhur mundësia e “aplikimit aktiv” të asaj që ata dijnë dhe kanë kuptuar, me fjalë të tjera shpjegimi duhet të kyç projekte të ndryshme. Përndryshe tërë ushtrimi do të mbetet artificial dhe ndrysh nga jeta e vërtetë. Të drejtat e fëmijëve kanë të bëjnë me situata reale dhe shpesh shumë serioze,duke nxitur fëmijët të marrin pjesë ,me sakrificë në sigurimin e drejtësisë dhe ndryshimeve sociale në suaza botërore. Hapat e parë në këtë drejtim do të ishin mesi i të jetuarit dhe të mësuarit. Si të dizajnohet dhe dekorohet oborri shkollor, të mbykqyret rruga e fëmijëve gjer në shkollë, mbrojtja nga droga, sjellja në orën mësimore, rregulla shkollore,etj. Sejcila nga këto tema duhet të ndërlihet përkatësisht me principet dhe të drejtat e fëmijëve.

Qëndrimet

Për të mësuar dhe praktikuar dituritë është vetëm punë gjysëm e kryer. Nxënësi që nuk i ka definuar pikëpamjet personale, ose nuk i është dhënë shansi për tu treguar, do ti harroj të drejtat e fëmijëve njësoj siç harondisa tema dhe përmbajtje, menjëherë posa ta mbyll librin. përmes lojës dhe roleve ushtrohen dhe testohen mendime të ndryshme, kurse nxënësit trajnohen si të diskutojnë për rastin e tyre. Mbetet hapsirë edhe për mosdurim dhe mospajtim mes nxënësve, por arsimtari nuk guxon të jep notë për atë se cilat qëndrime dhe mendime të nxënësve janë të drejta apo jo të drejta.

Bëj hapa të vegjel, por prap se prap i bëj ato!

Të kthehemi se fundmi, në shembullin tonë me tullumbacat, në klasë të tretë. Ky koncept bën dallim mes diturive, shkathtësive të implementimit, zhvillimit të qëndrimeve personale dhe të shprehurit e mendimeve.

Si do që të jetë, më me rëndësi është që nxënësit ,aktivisht të kyçen në mësim dhe njëkohsisht të përjetojnë atë. Prej tani e tutje, fëmijët do ti asocojnë të drejtat e tyre me tullumbace-shumengjyreshe, me të qeshur, edhe pse ndoshta ende nuk kanë kuptuar të tërën.

Duke mësuar të drejtat e fëmijëve:

Pyetje të rëndësishme - kryesore për zgjidhje të drejtë të metodave të shpjegimit

Në këtë doracak u munduam të përshkruajmë projekte të vogla për të drejtat e fëmijëve dhe të mësuarit e tyre në atë mënyrë që mësimi i bazuar në detyrë, fokusohet në zgjidhje problemesh, mësim inaktiv ku nxënësi gjendet në qendër të vëmendjes, kurse shkolla si model shoqëror e udhëhequr nga principet e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve. Ato metoda me një qasje të këtille, bartin pjesë të rëndësishme të porosisë. Këto pyetje mund t'ju shërbejnë si udhërrëfyes drejt planifikimit të projekteve të këtij lloji, në të ardhmen.

Pyetjet kryesore/kyçe	Referenca drejt moduleve të këtij libri
A përgjigjen metodat dhe temat e ligjeruara me dituritë, qëndrimet dhe të ariturat e nxënësve?	Arsimtari dyhet të vendosë për vehtëvehten dhe të sjellë vendim, se çfarë udhëheqje ju është e duhur nxënësve të tij.
Struktura e nxënësve (p.sh: gjinia, përkatësia etnike, nevojat për mësim) i definojnë kushtet e shpjegimit në klasë. Ai i kishte parasysh arsimtari ato kushte?	Vetëm arsimtari mund ti përgjigjet kësaj pyetjeje. Ndoshta kushtet specifike në klasë kërkojnë që ndonjë temë të përshtatet në menyrë adekuate.
A e përmbajnë metodat dëshirën e nxënësve për të mësuar diçka më shumë?	Globalisht, qasja e mësimit bazuar në detyrë, nënkupton pjesëmarrje aktive të nxënësit.
A e përmbajnë metodat, inicijativën personale të nxënësve për të mësuar dhe a lejojnë, që vet ata të organizojnë procesin e të mesuarit?	Gjithë njësite mësimore janë të parapara si projekte. Kjo ju jep përgjegjësi nxënësve për punën e tyre, duke kyqur edhe përgjegjësinë për orarin kohor. Rreziku nga mospësuksesi përgjigjet në situata reale të përditshmërisë.
A lejojnë metodat që nxënësit të mbajnë-ruajnë përvojën dhe sjelljen tyre personale?	Të gjitha modelet përfshijnë fazën fillestare, kurse në disa prej tyre nxënësit duhet të reflektojnë përvojën personale në mësim
Këto metoda, i inkurajojnë nxënësit që të vëzhgojnë problemet dhe temat nga aspekte të ndryshme?	Ora 1- Unë kam emër. -Fëmijët bëhen të vetëdijshëm për atë se si perceptohen njëri me tjetrin ,dhe se secili individ është i vetëm. -Ora 8 – Portfolio.

	Të drejtat e fëmijëve analizohen nga perspektiva të ndryshme.
A përmbajnë metodat, mendim kritik dhe, diskutim në orë?	Gjitha modulet kyçyn në mendimin kritik dhe diskutim.
A lejojnë metodat mësim “përmendësh, -në dorë”	Puna artistike, kutia e çmueshme, sjellja si magjistar..
Metodat a ju lejojnë nxënësve të shohin sa janë ata kompetent?	Të mësuarit në mënyra të ndryshme (punë e pavarur, punë koperative, sesione hyresë) -Projektet çojnë drejtë rrezultateve të parashikuara. - Të mësuarit ju ndihmojnë nxënësve të vetëdijesohen për zhvillimin dhe aritjet e tyre
A lejojnë metodat që nxënës të ndryshem të mësojnë në mënyra të ndryshme? (mësim konstruktiv)	Puna e panvarur dhe aktivitete të ndryshme ju lejojnë nxënësve të mësojnë në mënyra të ndryshme, në pajtim me nevojat e tyre personale.
Këto metoda , a i ushtrojnë nxënësit në zhvillimin e shkathtësive themelore? (psh. Mbledhja e informatave, prezentimi, planifikimi i projektit, puna në grupe).	Shkathtësitë - aftësitë themelore, në mënyrë ideale ushtrohen gjatë punës në projekte, të mbledhurit e informatave, të mbajturit e prezenteve, planifikimi i projekteve, puna në grupe.

Disa pyetje , shpesh të parashtruara lidhur me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në Kombet e Bashkuara.

Çka paraqet Konventa?

Konventa për të drejtat e fëmijëve pranë OKB-së , paraqet marëveshje internacionale për të drejtat e njeriut, e sjellur në Kuvendin e Përgjithshëm të OKB-së në vitin 1989.

-Përmban 41 nene për të drejtat e të rinjëve, një nen për “mendim publik dhe arsimim, dhe 12 nene për atë se si të mbykqyret, ndryshohet dhe aplikohet-perdoret” -Konventa.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është e pranuar nga më shumë vende, me shumë se çdo ligj internacional për të drejtat e njeriut. Deri në janar të vitit 1886 (?!) Konventën e pranuan 187 shtete.

Do të thotë, çka paraqet fëmija sipas Konventës?

Kur Kombet e Bashkuara, thonë “fëmijë” , mendojnë në gjithë njerëzit e rrinj të moshës nën 18 vjet , përveç kur moshë, e pjekurisë (kur dikush e llogarit veten të rritur) arrihet më herët. Këtë e sqron më së miri **Neni 1** Konventës.

Si funksionon Konventa?

Edhe pse Konventa nuk është ligj nacional, principet e saj patjetër duhet të reflektohen mbi legjilasturën nacionale, politike dhe programet e vendeve që kanë nënshkruar dhe aplikuar atë - Konventën. Qeveria gjithashtu rregullisht duhet të dorzojë raport në OKB , për zhvillimin ,

përparimin dhe implementimin e Konventës. Sistemi për njohtim –informim , bën presion në qeveri për të respektuar të drejtat e nejrëzve të rinj.

A kontribuon Konventa e KB –ra , për (ndonjë) ndryshim të jetës sonë?

Me aplikimin e kësaj Konvente qeveria obligohet të respektojë të drejtat e njerëzve të rinj nën 18 vjet, të marrin pjesë në sjelljen e vendimeve me rëndësi për to., të jetojnë të mbrojtur nga e keqja. Neni 4 thotë se kur qeveria pranon këtë Konvente , ajo duhet të ndërmer “të gjitha masat përkatëse” që ajo të jetë e implementuar .. gjithashtu thuhet se: kur janë të rrezikuara të drejtat tona ekonomike, sociale dhe kulturore, qeveria është e pajtimit të bëjë maksimumin që mundet, ata ti mbrroje (të rrinjtë). Me të kuptuar se :ç’tuhet dhe mendohet me Konventë, atëhere mund të punojmë drejt asaj që këto të drejta të bëhen rregulla sipas së cilës përcaktohet trajtimi i njerezve të rinj.

Të drejtat e femijëve-pjesë e procesit të të drejtave njerëzore.

Të drejtat e fëmijëve dhe standardet me të cilat të gjitha qeveritë pajetër duhet të drejtohen kah realizimi i këtyre të drejtave është tërësisht dhe në menyre precize e shkruar në një dokument internacional, për trajnim të të drejtave njerëzore-Konveta për të Drejtat e femijëve. Kjo Konventë është instrument më i pranuar në historinë e të drejtave njerezore-është aplikuar në të gjitha shtetet e botes, pos dy shteteve. Me ratifikimin e këtij dokumenti qeveritë nga gjithë bota, janë të obliguara në mbrojtjen dhe alikimin e të drejtave të njeriut, dhe si të tilla janë përgjegjëse para Bashkësisë Internacionale.

E ndërtuar mbi bazen e sistemeve të ndryshme të drejtësisë dhe traditave kulturore, Konventa e të Drejtave të Fëmijëve është sot (garniture) univerzale, pa “standarde biseduese dhe detyrimesh-obligimesh” i specifikon të drejtat themelore njerëzore të cilat i kanë fëmijet gjithkund-pa diskriminim:

-e drejta për jetë

-e drejta e zhvillimit të plotë

-e drejta për mbrojtje nga ndikimet e dëmtuese,keqëpordorim dhe eksploatim.

-e drejta për pjesmarje të plotë në familje, dhe jetën kulturore dhe shoqërore.

Secila e drejtë nga Konventa është e trashëguar, e mbron dinjitetin e njeriut dhe zhvillimin harmonik të sejcillit fëmije. Konventa i mbron të drejtat e fëmijeve duke vendosur standarde për mbrojtje shëndetsore , arsimore dhe drejtësisë, dhe shërbime qytetare dhe shoqërore. Këto standarde janë bazë për aritje të përparimit. Konventa e të drejtave të fëmijeve është instrument i parë legal i krijuar për implementimin e plote të të drejtave njerëzore, qytetare dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike , sociale dhe kulturore.

Dy protokolet alternative; për kyçjen e fëmijëve në konflikte të armatosura dhe trejetinë e fëmijëve, prostitucioni dhe pornografia fëmijnore; janë pjesë përbërëse e Konventës me qëllim që të forcohet vet konventa në kuadër të këtyre fushave. Ata hynë në fuqi më 12-18 shkurt të vitit 2002.

Zhvillimi i shoqërive moderne udhëzon edhe për një pyetje tjetër: të drejtat e lirisë mbështesin zhvillimin e shoqërive pluraliste duke inkurajuar nivele të larta të mënyrës së të jetuarit individual.

Të drejtat njerzore dhe fëmijënore, kontibuan shumë për ndërtimin e botës si një vend më të sigurtë dhe më human për jetë, dhe për modernizimin të sistemeve politike, ekonomike, dhe kulturore në mbarë botën. Si do që të jetë asnjehere nuk guxojmë që këtë ta marim si “ të

gatshme për shëndet “ , dhe sejcila gjenerat patjetër duhet të kontribuoj për zhvillimin e vetë, të lufone për vehte dhe ardhmerinë e saj.

Të drejtat e njeriut, mbi të cilat bazohen të drejtat e fëmijëve, kanë traditë shumëvjeçare. Revolucioni amerikan dhe francez, janë inspiruar mu nga kjo pikëpamje. Sot, ato janë dokumente në forme të shkruar dhe të pashkruar e kushtetuta e shumë shteteve demoratike. Gjatë historisë të drejtat e njeriut janë të një rëndesie të madhe për mbrojtjen e të dobëteve (pafuqishëm) nga të fortit (fuqishmit). Kjo ju detikohet edhe të drejtave të fëmijëve: të miturit llogariten grupi me status legal më të dobët në shoqëri.

Procesi i të drejtave njerezore, revolucionar dhe evolutiv ka kontribut të madh mbi gjeneratat e sukseshme të të drejtave njerezore: të drejtat klasike për liri, të drejtat sociale për barazi dhe ende si temë për diskutim janë të drejtat ekologjike në kuptimin e temave për zhvillim dhe mvarësi reciproke në botën gjithnjë e më të globalizuar në të cilën jetojmë. Procesi i zhvillimit dhe zgjerim të të drejtave të fëmijëve, ende është dhe do të jetë i pambaruar, pyetja univerzale për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve ende hulumtohet, të drejtat e njeriut dhe fëmijëve nuk aplikohen në disa vende diktatoriale dhe autokratike, kurse zhvillimi dinamik i shoqërisë moderne dhe teknologjisë parashton pyetje dhe sprova të reja. Psh. si të ndërohet privatësia e komunikimit në epokën e internetit?

Të drejtat e fëmijëve, të drejta natyrore (jus-natyrals)

Të drejtat e njeriut janë univerzale. Ajo është betimi para të ciles qëndrojnë ose thyhen-shkelen. Ata janë të pandara dhe nuk mund të tregtohet me to.

Të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore. Prandaj asnjë shtet nuk ka fuqi të ndalojë-pengojë, perkundrazi duhet ti pranojë dhe mbroj ata. Të drejtat e njeriut implikojnë se shteti ju shërben individëve dhe jo të kundërtën. Ata vazhdojnë për çdo njeri pa dallim të moshës, gjinise, përkatesise etnike të tij etj.

Si do që të jetë, të drejtat e njeriut në vehte bartin përgjegjësi. Psh e drejta e lirisë individuale patjetër duhet pasur të njejtin kuptim edhe për njerëzit tjerë : liria ime nuk mund të zmadhohet në llogari të lirisë së huaj. Psh, liria e të shprehurit nuk kyq të drejtën e nënçmimit të njere

zve të tjerë. Pyetja rreth balansimit dhe kufizimit të të drejtave të njeriut janë burim i vazhdueshëm i temave që duhet diskutuar dhe sjellur vendime politike. Kjo i sqaron arsyt pse në vende të ndryshme demokratike në botë paraqiten “ brende” të të drejtave të njeriut

Si janë krijuar të drejtat e fëmijëve? (historiku)|

1945	Pas luftës së dytë botërore shumë popuj të botës formuan Union – u themaluan Kombet e Bashkuara (KB-ra)
10 dhjetor 1948	Në këtë ditë KB-ra e pranojnë Deklaratën Univerzale për të drejtat e njeriut. Kto të drejta përdoren edhe tek fëmija. Por së shpejti u propozua , që ato të jenë nën mbrojtje speciale, sepse fëmijet janë diçka të veçant.
1950	U soll verzioni i parë i të drejtave të fëmijëve. Përfaqësuesit në KB-ra diskutojnë të njejtën disa vite.

20 nëntor 1959	Në këtë ditë KB-ra e pranon deklaratën e të drejtave të fëmijëve. Kjo deklaratë nuk është obliguese për të gjitha shtetet por shërben si porosi (rekomandim) për vendimet e tyre të ardhshme.
1979	Në mbarë botën, ky vit festohet si vite i fëmijut. Të drejtat e fëmijëve diskutohen ane e mbanë. Shumë më tepër njerëz dëshirojnë, të drejtat e fëmijëve të përpunohen në detale dhe të jenë edhe më të mbrojtura me ligje.
20 nëntor 1989	Në këtë ditë Kuvendi Gjeneral i OKB-së e pranon konventën e të drejtave të fëmijëve. Prej atehere qeveritë gati të të gjitha shteteve e nenshkruan konventën e të drejtave të fëmijut. Ata premtojnë të zgjerojnë informacionet për të drejtat e fëmijëve, ti aplikojnë dhe ti kushtojnë kujdes të veçantë mbrojtjes së fëmijëve. Mirpo, në shumë vende të botës prap se prap fëmijet vuajnë nga padrejtësitë serioze. Secili prej nesh është përgjegjës dhe patjetër sillet në pajtim me faktin se gjithë fëmijet në bote i gëzojnë këto të drejta të fëmijëve.

Deklaratat për të drejtat e fëmijut (20 nëntor) 1959

Të drejtat speciale të fëmijëve për herë të parë u shpallën në deklaratën e të drejtave të njeriut (1948), Neni \ 25-2 “mamia, dhe fëmijëria kanë mbrojtje dhe ndihmë të veçantë” Ky dokument është rezolut jo obligative e kuvendit të KB-ra ;nuk duhet të perzihet me konventën internacionale për të drejtat e fëmijëve e cila u soll në kuvendin e KB-ra ne tridhjet vjetorin e këtij dokumenti- 20 nëntor 1989.

Parimi-principi 1

Fëmiju do të gëzojë të gjitha të drejtat e shkruara në këtë deklaratë. Çdo fëmije pa përjashtim i takojn këto të drejta, pa dallim dhe diskriminim në llogari të ngjyrës, races, gjinisë, gjuhës, religjion, mendimit politik apo lloj tjetër, prejardhje nacionale dhe shoqërore, pronë –si, i lindur apo status tjetër, i tij apo familjes së tij.

Parimi-2

Fëmiju gëzon mbrojtje speciale, me ligj dhe mënyra tjera i jepet mundësia institucionale, për zhvillim fizik, mental, moral, shpirtëror dhe shoqëror në mënyre të shëndoshë dhe normale në kushte të lirise dhe dinjitetit.

Parimi-3

Me të lindurit, fëmijut i takon emri dhe nacionaliteti.

Parimi-4

Fëmiju do të fezojë të mirat e sigurimit shoqëror. Do të rritet dhe do të zhvillohet shëndetshëm, do të mundësohet përkujdes special dhe mbrojtje personale dhe të nënës së tij, duke kyçur

përkujdesin para dhe pas lindjes. Fëmiju do të ketë të drejtë në ushqim adekuat, shtëpi, rekreacion, dhe shërbime mjeksore.

Parimi-5

Fëmiju i cili është i hendikepuar fizik, mental ose social do të ketë trajtim special, arsimim dhe përkujdesje në pajtim me kushtet e tij konkrete.

Parimi-6

Fëmijut për zhvillim të plote dhe harmonik të personalitetit të tij i është e nevojshme dashuri dhe mirëkuptim. Fëmiju do të rritet gjithmonë kur ajo është e mundur, nën kujdesin dhe përgjegjësinë e prindërve të tij, dhe atmosfere të lidhshmërisë morale dhe sigurisë materiale. Nuk guxon të ndahet nga e ëma e tij në disa vitet e para të tij përveç në disa raste. Shoqëria dhe shteti kanë obligim që ti miundesojnë kujdes të veçantë fëmijëve pa familje dhe atyre pa kushte adekuate të perkrahje financiare nga shteti është e këndëshme për familjet e mëdha.

Parimi-7

Fëmijës i takon shkollim fillor i cili do të jetë pa pagesë dhe moral, do ti mudësohet arsimim që të promovoj kulturën e tij dhe ti mundësojë në baza të barabarta me të gjithë, ti zhvilloj aftësitë e tyre, mendimin personal, dhe ndjenjën e përgjegjësisë morale dhe shoqërore dhe të bëhet anëtar i dobijshëm në shoqëri.

Parimi udhëheqës i atyre të cilët janë përgjegjës për arsimim të fëmijëve do të jetë në interesin e tij më të mirë; ajo përgjegjësi në fillim bie mbi supet e prindërve.

-Fëmija do të ketë mundësi të plotë, në lojë dhe reaktion të cilët do të kenë të njëjtin qëlim sikurse arsimimi; shoqëria dhe autoriteti publik do të mundohen të promovojnë për përmbushjen e kësaj të drejte.

Parimi-8

Fëmija, në të gjitha rrethanat, ndër të parët do të jetë ai që do të merr mbrojtjen dhe lehtësimin.

Parim -9

Fëmija do të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e keqtrajtimit, keqpërdorimit, dhunës dhe eksploatimit. Nuk do të jetë mjet, lëndë për trafikim dhe tregeti me njerëz në asnjë formë.

-Fëmija nuk do të jetë i nënshtuar në punësim para se të arrijë moshën përkatëse; në asnjë rast nuk do të jetë i kështu ose sprovuar për të marrë pjesë në çfarëdo punësimi që do të sjell gjer te paragjykimet mbi shëndetin e tij ose shkollimin apo që do të ndikojë (negativisht) mbi zhvillimin e tij fizik, mental dhe moral.

Parimi-10

Fëmija do të jetë i mbrojtur nga çdo veprim me pjesëmarrje racore, religjioze ose çfardo lloj formë tjetër diskriminimi. Do të jetë i edukuar në frymën e mirëkuptimit, tolerancës, miqësisë mes njerëzve, paqes dhe vëllazërisë univerzale dhe përkushtim të tërësishëm të talentit të tij dhe energji kah bashkqytetarët e tij.

KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor
1989

PREAMBULA

Shtetet Palë në këtë Konventë,

Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është baza e lirisë, drejtësisë dhe e paqes në botë,

Duke mbajtur parasysh faktin se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe kanë vendosur të nxisin përparimin shoqëror e të krijojnë kushte më të mira jetese, në një liri më të madhe,

Duke pranuar se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdonjëri mund të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e parashtruara në to, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhjeje ose çdo lloj gjendjeje tjetër,

Duke kujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë,

Të bindur se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi,

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi,

Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit,

Duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës,

Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës “fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”,

Duke kujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në një familje ushqyese dhe birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Periudha të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe Konflikti të Armatosur,

Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë,

Duke mbajtur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në

mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës,
Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim,
U morën vesh për sa vijon:

PJESA I

Neni 1

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 2

0. 1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.
0. 2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 3

0. 1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.
 0. 2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjorisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.
3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 4

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 5

Shtetet Palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose persona të tjerë ligjorisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.

Neni 6

0. 1. Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
0. 2. Shtete Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 7

2. 1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.
2. 2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

Neni 8

2. 1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.
2. 2. Në qoftë se një fëmijë i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni 9

2. 1. Shtetet Palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rasteve kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.
2. 2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.
2. 3. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.
2. 4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarët ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni 10

1. Në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të

largohen prej tij, për arsye ribashkimi të familjes, trajtohen nga Shtetet Palë në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu që

paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.

2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni 11

1. Shtetet Palë marrin masa për të luftuar zhvendosjet dhe mosrikthimet e paligjshme të fëmijëve në vend të huaj.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë nxisin përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 12

1. Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.

2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar

Neni 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kujfijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

□.(a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose

□.(b) Mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 14

1. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.

2. Shtetet Palë respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

3. Liria për të manifestuar fenë ose bindjet e tij mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të të tjerëve.

Neni 15

2. 1. Shtetet Palë njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.
2. 2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 16

2. 1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.
2. 2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla.

Neni 17

Shtetet Palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për këtë qëllim Shtetet Palë:

- .(a) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29;
- .(b) Inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të tilla informacioneve dhe materialeve nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare;
- .(c) Inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë;
- .(d) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv, mbajnë parasysh, në mënyrë të veçantë nevojat gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton;
- .(e) Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysh dispozitat e neneve 13 dhe 18.

Neni 18

2. 1. Shtetet Palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.
2. 2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.
2. 3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur.

Neni 19

2. 1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. 2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 20

5. 1. Një fëmije, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.

5. 2. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

5. 3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, *inter alia*, formën e vendosjes në një familje, të “*Kafalasë*” sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevoje, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Neni 21

Shtetet Palë, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e birësimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe:

□.(a) Sigurojnë që birësimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që birësimi të lejohet duke mbajtur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për birësimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

□.(b) Pranojnë se birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje ushqyese ose birësuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme përkujdesjeje në vendin e tij të origjinës;

□.(c) Sigurojnë që, në rast birësimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barazvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e birësimit në vendin e tij;

□.(d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast birësimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të;

□.(e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përipiqen në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Neni 22

2. 1. Shtetet Palë marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur, për t'i lejuar atij të gëzojë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

2. 2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të

sigurojnë informacionin e nevojshëm për bashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

Neni 23

3. 1. Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

3. 2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

3. 3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektivisht të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integritet shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

3. 4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 24

5. 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

5. 2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

- .(a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmimore;
- .(b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
- .(c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
- .(d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
- .(e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;
- .(f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

1. 3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.
2. 4. Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 25

Shtetet Palë i njohin fëmijës, për të cilin është vendosur nga autoritetet kompetente për të qenë nën kujdesje, mbrojtje ose trajtim fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë vendosje.

Neni 26

1. 1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore, përfshirë sigurime shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.
2. 2. Ndihamat, ku është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe personave përgjegjës për mbajtjen e tij si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 27

1. 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
2. 2. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.
3. 3. Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevoje, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin.
4. 4. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit

ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, në rastet kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Shtetet Palë favorizojnë aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose përfundimin e marrëveshjeve të tilla si dhe miratimin e rregullimeve të tjera të duhura.

Neni 28

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

□.(a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;

□.(b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;

□.(c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;

□.(d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;

□.(e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

□.(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;

□.(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;

□.(c) Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;

□.(d) Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;

□.(e) T'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenit 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të atillë që të cënojë lirinë e personave fizikë ose juridikë, për të krijuar e drejtuar qendra arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimit që jepet në këto qendra të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

Neni 30

Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrojë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 31

5. 1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

5. 2. Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni 32

2. 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

2. 2. Shtetet Palë marrin masa legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Shtetet Palë në mënyrë të veçantë:

□.(a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit në punë;

□.(b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës;

□.(c) Japin dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

Neni 33

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Neni 34

Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

□.(a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;

□.(b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;

(c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 35

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni 36

Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqënien e tij.

Neni 37

Shtetet Palë sigurojnë që:

□.(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;

□.(b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

□.(c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

□.(d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 38

3. 1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijën.

3. 2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.

3. 3. Shtetet Palë nuk rekrutojnë në forcat e tyre të armatosura asnjë person që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona më të rritur se 15 vjeç por më të vegjël se 18 vjeç, Shtetet Palë përpiqen të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë.

3. 4. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur.

Neni 39

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Neni 40

2. 1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. 2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasyh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:

(a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

(b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijnë:

□.(i) Të prezumohet i pafajtshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;

□.(ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;

(iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

□.(iv) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.

□.(v) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.

□.(vi) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

(vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.

3. Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

□.(a) Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paafte për të shkelur ligjin penal;

□.(b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me

mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

Neni 41

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk cënon dispozitat më të favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijës, që mund të parashikohen:

□.(a) në legjislacionin e një Shteti Palë; ose

□.(b) në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë Shtet.

PJESA II

Neni 42

Shtetet Palë marrin përsipër t'ua bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e kësaj Konvente, si të rriturve ashtu edhe fëmijëve, me anë të mjeteve energjike të përshtatshme.

Neni 43

1. 1. Me qëllim që të shqyrtohen përparimet e arritura nga Shtetet Palë në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër prej tyre në bazë të kësaj Konvente, krijohet një Komitet mbi të Drejtat e Fëmijës, i cili kryen funksionet e caktuara si më poshtë.

2. 2. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe që njihen si kompetentë në fushën që trajton kjo Konventë. Anëtarët e tij zgjidhen nga Shtetet Palë midis shtetasve të tyre dhe marrin pjesë me titull personal, duke pasur parasysh një shpërndarje gjeografike të drejtë dhe sistemet juridike kryesore.

3. 3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votë të fshehtë, nga një listë personash të caktuar nga Shtetet Palë. Çdo Shtet Palë mund të caktojë një kandidat nga shtetasit e tij.

4. 4. Zgjedhja e parë bëhet jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas zgjedhjet bëhen çdo dy vjet. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara fton me shkrim Shtetet Palë të propozojnë kandidatët e tyre brenda një afati dymujor. Sekretari i Përgjithshëm bën më pas listën alfabetike të kandidatëve të caktuar, duke cilësuar Shtetet Palë që i kanë caktuar dhe ua paraqit ata Shteteve Palë në këtë Konventë.

5. 5. Zgjedhjet bëhen gjatë mbledhjeve të Shteteve Palë, të organizuara nga Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, në të cilat duhet të jenë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e Shteteve Palë, kandidatët të zgjedhur në Komitet janë ata që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të Shteteve Palë të pranishëm dhe votues.

6. 6. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata mund të rizgjidhen në qoftë se kandidatura e tyre paraqitet përsëri. Mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbaron pas dy vjetësh. Emrat e këtyre pesë anëtarëve hidhen në short nga Kryetari i mbledhjes, menjëherë pas zgjedhjes së parë.

7. 7. Në rast se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqjen ose deklaron se për çdo arsye tjetër nuk mund t'i kryejë më funksionet e tij në Komitet, Shteti Palë, që kishte paraqitur kandidaturën e tij, emëron një tjetër ekspert nga shtetasit e vet, për të plotësuar vendin e lirë deri në përfundimin e mandatit korrespondues, gjë që i nënshtrohet miratimit të Komitetit.

8. 8. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

9. 9. Komiteti zgjedh byronë e tij për një periudhë prej dy vjetësh.

10. 10. Mbledhjet e Komitetit zakonisht mbahen në Selinë e Organizatës së Kombeve të

Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm, të caktuar nga Komiteti. Komiteti mbledhet zakonisht çdo vit. Zgjatja e sesioneve të tij përcaktohet dhe ndryshohet, në rast se është e nevojshme, nga një mbledhje e Shteteve Palë në këtë Konventë, me rezervën e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

3. 11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara vë në dispozicion të Komitetit personelin dhe pajisjet e nevojshme, për të kryer me efektshmëri funksionet që i janë besuar në bazë të Konventës.

3. 12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të krijuar në bazë të kësaj Konvente paguhen nga të ardhurat e OKB-së, sipas kushteve dhe modaliteteve të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 44

1. Shtetet Palë marrin përsipër të paraqitin në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raporte mbi masat e marra për të përmbushur të drejtat e njohura në këtë Konventë dhe mbi përparimet e realizuara në gëzimin e këtyre të drejtave:

□.(a) Brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Shtetet Palë;

□.(b) Në vazhdim në çdo pesë vjet.

2. 2. Raportet e paraqitura në zbatim të këtij neni tregojnë faktorët dhe vështirësitë, në rast se ka, që kanë ndikuar në shkallën e përmbushjes nga Shtetet Palë të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Raportet duhet të përmbajnë gjithashtu të dhëna të mjaftueshme për t'i dhënë Komitetit një ide të plotë për zbatimin e Konventës në vendin përkatës.

2. 3. Shtetet Palë, që kanë paraqitur në Komitet raportin e parë të plotë, nuk përsërisin në raportet që i paraqesin atij në vazhdim, sipas pikës (b) të paragrafit të parë të këtij neni, sqarimet kryesore, të komunikuar qysh më parë.

2. 4. Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të dhëna plotësuese, që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

2. 5. Komiteti i paraqit çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror, një raport mbi veprimtarinë e tij.

2. 6. Shtetet Palë sigurojnë një shpërndarje të gjerë të raporteve të tyre në vendet e tyre.

Neni 45

Për të arritur zbatimin efektiv të Konventës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën që mbulon kjo Konventë:

□.(a) Agjencitë e specializuara, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të gjitha organet e tjera kompetente, që ai do ta gjykojë të arsyeshme, për të dhënë mendime të specializuara mbi zbatimin e Konventës në fusha që kanë të bëjnë me mandatin e tyre përkatës. Ai mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur raporte mbi zbatimin e Konventës në sektorët që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre;

□.(b) Komiteti u transmeton agjencive të specializuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organeve të tjera kompetente, në rast se e sheh të nevojshme, çdo raport të Shteteve Palë, që përmban një kërkesë ose që tregon një nevojë për këshilla ose ndihmë teknike,

së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e Komitetit, në rast se ka të tilla;

□.(c) Komiteti mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme, që t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm, të ndër marrë në emër të tij studime për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;

□.(d) Komiteti mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme, të bazuara në të dhënat e marra në zbatim të neneve 44 dhe 45 të kësaj Konvente. Këto sugjerime dhe rekomandime të natyrës së përgjithshme i transmetohen çdo Shteti Palë të interesuar dhe i përcillen për dijeni Asamblesë së Përgjithshme, të shoqëruara, në rast se ka të tilla, me vërejtjet e Shteteve Palë.

PJESA III

Neni 46

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet.

Neni 47

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Konventa do të qëndrojë e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 49

1. 1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit.

2. 2. Për secilin Shtet që ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 50

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon pastaj amendamentin e propozuar Shteteve Palë, duke kërkuar që t'i bëjnë të ditur nëse janë për thirrjen e një konference të Shteteve Palë për shqyrtimin e propozimit dhe të hedhjes në votë. Nëse brenda katër muajve pas datës së këtij komunikimi, të paktën një e treta e Shteteve Palë shprehen për thirrjen e një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën kujdesin e

Organiztës të Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

2. 2. Një amendament i miratuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jetë pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë.

3. 3. Kur një amendament hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për të gjithë Shtetet Palë, që e kanë pranuar dhe Shtetet e tjerë që mbeten të lidhur me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të

gjithë amendamentet e mëparshme të pranuar prej tyre.

Neni 51

4. 1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe ua dërgon të gjithë Shteteve tekstin e rezervave të bëra nga Shtetet në çastin e ratifikimit ose të aderimit.
4. 2. Nuk lejohet asnjë rezervë e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.
4. 3. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili informon për këtë të gjithë Shtetet Palë në Konventë. Njoftimi hyn në fuqi në datën kur ky është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 52

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës kur njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitues i kësaj Konvente.

Neni 54

Originali i kësaj Konvente, bërë në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, franceze dhe ruse, me vlerë të barabartë, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Për vërtetim, të nënshkruarit, të plotfuqishëm e të ngarkuar ligjërisht nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.

Tre goje të drejten!

Edicioni rinor kanadez, jo konvencional për Konventen e Kombeve të Baskuara për të drejtat e femijëve.

Pse ekziston botim rinor i konventës?

Versioni konventës i sjellur nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe i miratuar nga vende të shumta të botës paraqet - është dokument ligjor i shkruar në gjuhë teknike. Nëse njerëzit e rinj i kuptojnë të drejtat tyre dhe përgjegjësitë, edhe ne duhet fillojmë që ti vëmë punet si konventa me fjalët e saj. Në fillim të saj neni 42 nga konventa thotë se ajo është përgjegjësi e qeverive për ti përgaditur të rinjtë që të vetëdijesohen për të drejtat e tyre në mënyra të ndryshme. Pa dyshim versioni i shkruar rinor në konventën KB-ra është i shumëllojshëm dhe aktiv, që të na përgatis ne të jemi të ndergjegjshëm për të drejtat që i kemi.

Pas gjithë bisedës për të drejtat, çfarë është në përgjegjësi tona?

Të drejtat dhe përgjegjësitë nuk mund të jenë të ndara. Konventa e KB-ra flet për të drejtat që u janë garantuar njerezve të rinj nga ana e qeverise. Gjatë çdo lidhjeje pune mes shokëve, në familje, në shkollë, ekipe sportive ose shtete –(vende) duhet mbajtur mend se ne u jemi borxh disa gjëra të tjerëve, kurse ata të njëjtat neve na i kane borxh. Këto gjëra elementare - themelore që ua huazojmë të tjerëve përfshijnë respektin dhe tolerancën. Konventa e KB-ra i përshkruan këto gjëra themelore, qeverite ua kanë borxh njerezve të moshës nën 18 vjeç.

Cilat të drejta janë përfshirë në konventë?

Konventa mund të ndahet në katër grupe të drejtash:

- 1."duke marrë pjesë" –d.m.th. të jesh i kyqur në vendime, liri që t'ju bashkangjitesh të tjerëve, liri në të shprehurit e vetvetes dhe liri në pranimin e informatave nga burimet e ndryshme.
- 2."ta arijmë potencialin tonë" –i përfshijnë gjërat që na duhen për zhvillim të mundshëm të mirëfilltë. Ky grup i numëron rëndësinë e arsimimit, familjes, kulturën dhe identitetin e jetës sonë.
- 3."të jetosh mirë: e drejta jonë për mbijetesë"- i përfshijnë gjitha nevojat tona themelore. Këtu janë përfshirë ushqimi dhe shtëpia, standardi yne i jetesës dhe shëndeti yne.
- 4."të jesh i pa lënduar"- u lejojnë të rinjëve të jenë të mbrojtur nga shumë gjëra, përfshirë keqpërdorimin, mosepërfillja, eksploatimi ekonomik, tortura, kidnapimi-rëmbimi dhe prostitucioni.

I kemi ndikim, pse kemi të drejtë në pjesëmarje?

Neni 3

Në të gjitha vendimet që kane të bëjnë me ne, interesat tona më të mira do të duhej të shqyrtohen që më parë. Gjithashtu, qeveritë kanë përgjegjësi të jene të sigurtë se standardet institucionale respektohen në mënyrë që mundësojnë të gjithë në mënyrë adekuate të jemi të përkujdesur dhe mbrojtur.

Neni 12 -Të dëgjohen mendimet tona

Ne kemi të drejtë që të mesojmë qëndrimet tona për vendimet me ndikim në veçanti në çdo gjyq ose procedurë administrative të rëndësishme për ne.

Siç bëhemi më të vjetër,(moshuar) qëndrimet tona duhet që të meren parasysh sa më shumë. Të jemi të kyqur–përfshirë! Të mësojmë për pjesëmarjen e të rinjëve.

Neni 13 – Mundemi lirisht të shprehemi.

Ne kemi të drejtë të shprehemi, të pranojmë dhe përcjellim informata përmes gjithë medimeve, përfshirë shtypin, artin ose fjalën e thënë. Ne kemi përgjegjësinë të shprehemi në mënyrë që do ti respektojmë. Ne gjithashtu kemi të drejtë të jemi të lirë dhe të mos sulmohet nderi dhe reputacioni ynë.

Neni 17- Mediumet

Qeveritë kanë përgjegjësi të sigurojnë informata dhe materiale të kapshme për ne nga shumë burime nacionale dhe ndërkombëtare, sidomos kur ka për qëllim përparimin e lumturisë sonë dhe shëndetit

II Aritja e potencialit tonë: kemi të drejtë të zhvillohemi në atë që jemi.

Neni 5 –Respekt ndaj prindërve.

Qeveritë patjetër duhet të respektojnë të drejtat dhe përgjegjësinë e prindërve, familjes dhe tutor-ët, duke na mësuar dhe kahëzuar, kur ti aplikojmë këto të drejta.

Neni 7 -Emri ynë dhe nacionaliteti.

Pas lindjes kemi të drejtë të kemi emër, të fitojmë shtetësinë, dhe të jemi të përkujdesur nga prindërit tonë.

Neni 8-Ruajtja e identitetit tonë

Ne kemi të drejtë ta ruajmë dhe përseri të vërtetojmë emrin tonë, shtetësinë dhe lidhjen familjare.

Neni 10 –Bashkimi familjar

Nëse duhet të hyjmë apo lëshojmë vendin për të qenë përsëri së bashku me familjet tona, qeveritë kanë përgjegjësi të meren me rastin tonë shpejt dhe urgjentisht. Gjithashtu nëse prindërit tanë jetojnë në shtet tjetër, ne kemi të drejtë të kemi kontakte personale të drejtpërdrejta me to.

Neni 21- Te jesh i adaptuar (biësuar)

Në vendet ku birësimi është i lejuar, ajo patjetër duhet të jetë në interesin tonë më të mirë, dhe të jemi të mbikqyrur nga persona zyrtarë dhe kompetentë. Nëse biësimi zhvillohet në mes dy shteteve , qeveritë kanë përgjegjësi të sigurojnë standardet e biësimit dhe ato të jenë të njëjta në suaza të një shteti.

Neni 23-Njerëz të rinj të paaftë.

Nëse jemi të paaftë kemi të drejte për kujdë të veçantë dhe arsimim që do të na ndihmoj të arime vetëbesimin dhe të jetojme jetën në shoqëri .

Neni 28- Arsimimi im

Ne kemi të drejte në arsimim. Qeverite kanë përgjegjesi të garantojnë se shkollimi fillor është obligativ, pa pagesë, dhe se ne kemi qasje pranimit të njejtë në arsimim të mesëm dhe të lartë, dhe ajo disiplinë që shfrytëzohet në shkollat tona nuk është kundër dinjitetit tonë njerezore. Gjithashtu qeveritë do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për të ndihmuar të largojë paditurinë dhe analfabetizmin nëpër botë, të na ndihmojë që të kemi qasje drejt shkencës, teknologjisë dhe metodave mësimore bashkëkohore.

III-Të jetojme mirë: E drejta jonë për mbijetesë

Neni 6-mijetesa dhe zhvillimi ynë

Si njerëz të rinj, ne kemi të drejte për jetë. Gjithashtu qeveritë kanë përgjegjësi të sigurojnë mbijetesën dhe zhvillimin tonë në nivelin maksimal-të lartë të mundshëm.

Neni 9-ndarja nga prinderit tonë

Ne kemi të drejte të jetojme me prinderit tanë dhe të mos jemi të ndare prej tyre deri sa ajo nuk është kundër interesave tona më të mira.

Ne të gjitha dëgjimet ose procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me ndarje, në kemi të drejte të shprehim mendimin tonë. Gjithashtu kemi të drejtë të jemi në kontakt me të dy prinderit: Nëse ndarja rrjedh sipas vendimit të qeverisë, ajo duhet të na jep informata për gjendjen e prindërve tanë.

Neni 18 përgjegjësia e prindërve dhe tutorëve

Dy prindërit tanë ose tutori janë përgjegjës për edukimin tonë dhe kjo përgjegjësi ju takon atyre para se çdokuj tjetër. Qeveria do ti përkrahe prindërit tanë në rritjen dhe do të na binde se kujdesi për fëmijën është e kapshme për prindërit e punësuarë.

Neni 24-Shëndeti dhe kujdesi shëndetësor

Ne kemi të drejtën e arritur të nivelit më të lartë të shëndetit dhe kujdesit mjekësor. Qeveritë kanë përgjegjësinë të luftojnë me nivelet e vdekshmërisë së fëmijëve, të sigurojnë ndihmë mjekësore të rinjëve që të luftojmë kundër varfërisë dhe sëmundjeve ngjitëse, të garantojnë kujdes shëndetësor të grave-femrave të reja shtatëzane, të përgadisin arsimim shëndetësor të aritshëm të zhvillojnë kujdesin shëndetësor emegjent dhe të ndërpresin praktikatat e dëmshme tradicionale.

Neni 25- Shqyrtimi i strehimit tonë

Nëse jemi të vendosur nga ana e personave kompetent për të qenë të mbrojtur, kujdes dhe trajtim, kemi të drejtën e rregullshmërisë të këtij trajtimi të drejtë të vendosjes.

Neni 26-sigurimi ynë social

Ne kemi të drejte të beneficioneve nga sigurimi social, përfshirë edhe sigurimin social. Këto beneficione do të distribohen në raport me rezultatet dhe rrethanat tona dhe të prindërve apo tutorëve tonë.

Neni 27-Standardi ynë jetësor

Ne kemi të drejtë për një standard të barabartë për jetë të mirëqenies sonë fizike mentale, shpirtërore, morale dhe sociale. Prindëritë apo tutorët tonë kanë përgjegjësinë themelore që të bindemi se standardi jetësor i yni është i kapshëm.

Qeveria ka përgjegjësi të ju ndihmojë prindërve dhe tutorëve të cilat nuk mund të ju sigurojnë fëmijeve standarde të këtitilla.

Neni 31-Kohë të lirë dhe pushim

Ne kemi të drejtë në kohë të lirë dhe pushim dhe lirshëm të marrim pjesë në aktivitetet kulturore-artistike .

Neni 41-Standardet më të larta

Nëse standardet e ligjeve kombëtare dhe ndërkombetare janë më të mira, sipas kësaj konvente, do të aplikohen gjithnjë norma më të larta.

IV-Të jesh i padëmtuar: E drejta jonë në mbrojtje

Neni 2 –

Të gjitha të drejtat në konventë aplikohen për të gjithë njerëzit e rinjë pa dallim. Gjithashtu qeveritë kanë përgjegjësi të japin siguri se ne jemi të mbrojtur nga diskriminimi në bazë të statutit tonë familjare, origjinës, besimit etj.

Neni 11-Rëmbimi-kidnapimi dhe mbajtja e të rinjëve .

Qeveritë kanë përgjegjësi të luftojnë kidnapimin dhe mbajtjen e të rinjëve, qoftë ajo nga prindërit ose persona të tjerë.

Neni 19-Keqpërdorimi dhe moskujdesi-mospërfillja.

Ne kemi të drejtën të mbrohemi nga të gjitha llojet e keqtrajtimit:

Mental dhe fizik, mospërfillje dhe eksploatim përderisa jemi nën kujdesin e dikujt që është përgjegjës për ne. Ne gjithashtu kemi të drejtën të mësojmë si të parandalojmë dhe të sillemi ndaj keqtrajtimit.

Neni 20-Njerëz të rinjë pa familje

Nëse ne jemi të mohuar nga mjedisi familjare, kemi të drejtë në mbrojtje dhe ndihmë të veçantë nga qeveria jonë dhe ne kemi të drejtë për familje tjetër alternativë ose përkujdesje nga institucion tjetër i cili respekton të drejtat tona etnike, religjioze, kulturore dhe gjuhësore, në prapavijë.

Neni 22-Refugjatë të rinjë

Nëse jemi refugjatë dhe jemi të detyruar të lëshojmë vendin për t'ju larguar robërimit, ose në kërkim të statutit të refugjatit, ne kemi të drejtë në mbrojtje dhe ndihmë speciale nga qeveritë.

Neni 32-Puna-mundi i fëmijëve

Ne kemi të drejtë të jemi të mbrojtur nga eksploatimi ekonomik dhe secila punë që rrezikon: Shëndetin, arsimimin dhe zhvillimin tonë. Qeveria jonë ka përgjegjësi të vendosë moshën më të vogël për punësim, të përgadis rregulla dhe kushte për punë dhe të verifikojë dënime për shkeljen e këtyre rregullave.

Neni 33-Mbrojtja nga narkotikët

Ne kemi të drejtën për tu mbrojtur nga përdorimi jolegal i drogave dhe pjesëmarja në prodhimin dhe distribuimin e tyre.

Neni 34-Mbrojtja nga eksploatimi seksual

Ne kemi të drejte të jemi të mbrojtur nga eksploatimi dhe keqtrajtimi seksual duke përfshirë prostitucionin dhe pornografinë.

Neni 35-Mbrojtja nga trafikimi dhe tregëtia me njerës

Qeveritë kanë përgjegjësi të bëjnë gjithçka që është e mundur për të ndaluar tregëtinë me njerës dhe kidnapimin e njerëzve të rinj.

Neni 36-Të gjitha eksploatimet tjera

Ne kemi të drejtë për tu mbrojtur nga të gjitha llojet tjera të eksplimit.

Neni 37-Dënimi dhe burgosja

Ne kemi të drejtë të mbrohemi nga tortura, sjellje e ashpër ose dënimi dhe burgimi joligjor dhe invazionet tjera të lirisë. Qeveria jonë ka përgjegjësi të na bindë se dënimi kryesor dhe burgimi i përjetshëm janë të ndaluara për njerës të rinj.

Nëse privohet liria jonë, ne kemi të drejtë të trajtohemi me njerëzi dhe respekt, të na ruajnë ndaras nga të moshuarit, të mbahen lidhje me familje dhe të pranojmë ndihmë ligjore.

Neni 38-Lufta dhe konfliktet e armatosura

Nëse jemi në moshë nën 15 vjeç kemi të drejtë të jemi të përjashtuar nga çdo pjesmarje direkte në luftë dhe konflikte të armatosura.

Vetëm nëse nën ndikimin e konfliktit të armatosur, qeveria jonë ka përgjegjësi të na sigurojë mbrojtje dhe kujdes të veçantë.

Neni 39-Kujdesi rehabilitues

Nëse ne përjetojmë konflikt të armatosur, torurë, mospërfillje ose eksploatim kemi të drejte të pranojmë përkujdesje adekuate për shëndet.

Neni 40-Të rinjtë dhe drejtësia

Nëse ne jemi të akuzuar për shkelje të ligjit, kemi të drejtë të jemi të trajtuar me dinjitet, të paragjykohet ndershmëria jonë deri sa nuk tregohet fajësia, të na tregohen paditë të bëra kundër nesh, të fitojmë përkthyes në raste nevojë, të kemi proces të drejte, të respektohet privatësia jonë dhe e drejta në ankese të vendimit gjyqësor.

Qeveritë janë përgjegjëse të verifikojnë moshën më të vogël nën të cilën njerëzit e rinj janë në gjendje të thejnë ligjin. Gjithashtu, qeveritë patjetër duhet të llogarisin në masat tjera përkatëse nga kujdesja institucionale siç janë:

Këshillimi, mbikqyrja, lirim i kushtëzuar, kujdesi social, programet edukativo arsimore dhe trajnuese.

Mënyra për pjesëmarje

Pjesëmarja mund të jetë në shumë forma mes të cilave:

- 0. Leximi i temave dhe udhëzimeve konkrete.
- 0. Të shkruarit e temave dhe udhëzimeve konkrete
- 0. Tema të debatueshme
- 0. Punë shoqërore për përmbajtje të arsyes konkrete ose protestë kundër një vendimi të qeverisë
- 0. Formimi ose antarësimi në parti politike ose organizatë tjetër shoqërore
- 0. Pjesëmarja-prezenca në takime politike ose shoqërore
- 0. Emërimi për lider të një partie politike, organizate punuese ose organizate shoqërore
- 0. Votimi në zgjedhje
- 0. Pjesëmarja në kampanjë
- 0. Përfaqësimi në zyrë
- 0. Pagesa e tatimeve
- 0. Lobimi-agjitimi
- 0. Shërbimi ushtarak
- 0. Shfytëzimi i mënyrave egzistuese legale si: Kontaktimi me përfaqësues qeveritar, paraqitja- dorzimi i rasteve në gjyq
- 0. Protesta përmes demonstrimit, bojkotit dhe grevës

Internet faqe lidhur me të drejtat e fëmijëve

<http://www.ccf-fcge.ca/>

<http://www.cfc-efc.ca>

<http://www..srin.org/>

femijet

<http://www.child-abouse.com/childhouse/>

<http://www.cildäatch.uio.no/>

<http://www.child-solidiers.org/>

<http://www.echr.coe.int>

<http://www.ilo.org>

<http://www.unicef.org/voy/>

<http://www.coe.int/t/dg4/education/edc>

BOES ORG-organizatë e pavarur joprotabile e cila siguron informata për të drejtat e fëmijëve.

Rrjete për informata mbi të drejtat e fëmijëve.

Hulumtim internacional të fëmijëve Koalicioni për ndihmën e fëmijëve ushtarakë.

Arsimim për qytetërim demokratik dhe të drejtat njerëzore

© 2007 Këshilli i Europës

Ky publikim i përkthyer botohet në bashkëpunim me Këshillin e Europës. Për përkthimin nga gjuha angleze përgjegjët përkthyesi.

Botimi i parë

Përkthim dhe përshtatje të doracakut:
Naser Miftari, Profesor ne SHF 26 Korriku

Bashkëpunim profesionist dhe lekturë:
Fadil Sulejmani



COUNCIL CONSEIL
OF EUROPE DE L'EUROPE

Information Office
of the Council of Europe - Skopje
ul. Mito Hadzivasilev Jasmin b.b.
(Museum of the City of Skopje - 1st floor)
1000 Skopje MK

Tel.: ++389 (0)2 3123-616

Fax: ++389 (0)2 3123-617